



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2 PRILL 2026**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2. APRILA 2026. GODINE**

**PRILL - APRIL
2026**

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes për qasje në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-009 për ratifikimin e Amendamentit “nr.3 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018”,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-010 për ratifikimin e “Amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Programin IPA 2017”,
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-011 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia Diellore Fotovoltaike në KEK - Porta Globale,
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-012 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Projektin e efijencës së energjisë në ndërtesa publike,
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-013 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë “Projekti i Rrugës me Shpejtësi të Lartë Prishtinë - Mitrovicë” (Kredi shtesë) ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr.10/L-014 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë”,
11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë nga radhët e komunitetit shqiptar dhe për dy (2) anëtarë joshumicë në Komisionin e Pavarura të Mediave,
13. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për gjashtë (6) anëtarë nga komuniteti shqiptar, një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës,
14. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e deputetit Branislav Nikoliq në komisione parlamentare,
15. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Zubin Potokut për vitin 2026,
16. Formimi i Komisionit ad hoc për hartimin e “Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes”.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Poslanička pitanja,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-008 o ratifikaciji Sporazuma o pristupu visokom obrazovanju i prijemu na studije na Zapadnom Balkanu,
5. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-009 o ratifikaciji Amandmana br. 3 Finansijskog sporazuma između Republike Kosovo i Evropske unije za IPA program 2018,
6. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-010 o ratifikaciji Amandmana br. 2 Finansijskog sporazuma između Republike Kosovo i Evropske unije za IPA program 2017,
7. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-011 o ratifikaciji Kreditnog sporazuma između Republike Kosovo i Evropske investicione banke za projekat solarne fotonaponske energije u KEK-u - Global Gateway,
8. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-012 o ratifikaciji Kreditnog sporazuma između Republike Kosovo, koju predstavlja Ministarstvo finansija, rada i transfera, i Evropske banke za obnovu i razvoj (EBRD) za projekat energetske efikasnosti u javnim zgradama,
9. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-013 o ratifikaciji Kreditnog sporazuma "Projekat brze saobraćajnice Priština - Mitrovica" (dodatni kredit) između Saudijskog fonda za razvoj i Republike Kosovo,
10. Razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-014 o ratifikaciji Kreditnog sporazuma između Republike Kosovo i Evropske banke za obnovu i razvoj za projekat "Postrojenje za prečišćavanje otpadnih voda u Podujevu",
11. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije,
12. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za tri (3) člana iz reda albanske zajednice i dva (2) člana iz nevećinskih zajednica u Nezavisnoj komisiji za medije,
13. Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za šest (6) članova iz albanske zajednice, jednog (1) člana iz srpske zajednice i jednog (1) člana iz nevećinskih zajednica u Upravnom odboru Radiotelevizije Kosova,
14. Predlog Poslaničke grupe Srpske liste za imenovanje poslanika Branislava Nikolića u parlamentarne komisije.
15. Razmatranje budžeta Opštine Zubin Potok za 2026. godinu,
16. Formiranje ad hoc komisije za izradu "Nacrta zakona o sprečavanju samoubistva".

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës!

Sot në fillim të kësaj seance plenare kujtojmë demonstratat e pranverës së vitit 1981, një nga momentet më të qarta të artikulimit politik të shqiptarëve të Kosovës. Ato nisën nga studentët si reagim ndaj një padrejtësie konkrete, por shumë shpejt u shndërruan në kërkesë të hapur për barazi, dinjitet dhe status politik nën parullën “Kosova Republikë”. Përballë tyre shteti reagoi me masa represive duke konfirmuar hendekun midis kërkesës qytetare dhe strukturës së pushtetit të asaj kohe.

Demonstratat e vitit 1981 shënuan një kthesë në vetëdijen shoqërore dhe në drejtimin politik të vendit, duke vendosur themelet e proceseve që do të pasonin. I kujtojmë me respekt të gjithë ata që morën pjesë në to dhe që me qëndrimin e tyre i dhanë një drejtim të ri historisë së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar.

Në sallë janë të pranishëm, vetëm të konfirmojmë prezencën e deputetëve - 80 deputetë janë në të pranishëm, pra në këtë seancë.

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 30 mars të vitit 2026. Rendin e ditës për këtë seancë e keni para vetes, i cili është shpërndarë me kohë te deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj kohe kemi pranuar edhe propozime shtesë për rendin e ditës, prandaj zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër Kurti,

Kabinet qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me nenin 53 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dy i Rregullores së Kuvendit propozojmë plotësim ndryshimin e rendit të ditës së seancës së sotme, si në vijim: të shtohen në rend të ditës pikat 11, 12, 13 dhe 14 të seancës plenare të sotme:

- Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 10/L-015 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e zhvillimit të sektorit financiar të Kosovës.

- Pika e 12, Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 10/L-016 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencisë franceze për zhvillim për programin e kredisë të bazuar në politika.

- Pika e 13, Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 10/L-017 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KFV e Frankfurt am Main për programin e kredisë të bazuar në politika në sektorin e energjisë dhe klimës për Kosovën.

- Pika e 14, Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 10/L-018 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin “Lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0”.

Ndërkohë që pikat e parapara 11 deri në 16 të zhvendosen dhe shënohen si pikat 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të rendit të ditës. Katër këto marrëveshje, gjegjësisht projektligje, janë të domosdoshme për sigurimin e burimeve financiare të favorshme për zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare dhe avancimin e reformave strukturore në përputhje me prioritetet zhvillimore të Republikës së Kosovës. Këto janë shqyrtuar në Komisionin Funkcional dhe kanë marrë miratimin. Andaj, ftojme të gjithë deputetët që të miratojnë këtë propozim ndryshim për plotësimin e rendit të ditës së seancës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci!

Tani kërkohet deklarimi i shefave të grupeve parlamentare së pari për propozimin që u bë nga shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, e pastaj natyrisht për propozimin tjetër, sepse i përmenda që janë disa propozime për ndryshim të rendit ditës. Prandaj, kërkohet nga shefat e grupeve parlamentare, ju lutem që të deklaroheni vetëm për propozimin e zonjës Nagavci një herë si fillim.

Kush e dëshiron fjalën?

Zoti Tahiri, a dëshiron të flisni në emër të grupit për ndryshimin e rendit të ditës, përkatësisht propozimin?

ARIAN TAHIRI: Kryetare!

Të nderuar deputetë, Partia Demokratike e mbështet propozimin e propozuar nga zonja Nagavci që të futen në rend të ditës.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri. Nga LDK-ja zonja Lushaku, shefja e grupit.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: E përcjell fjalën te Besiani.

KRYETARJA: Më fal, zoti Mustafa!

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetare!

Përderisa Lidhja Demokratike e Kosovës në parim mbështet marrëveshjet ndërkombëtare, kemi një rast të veçantë këtu, ku të martën është ftuar Komisioni për Buxhet për të mërkurën dhe menjëherë pas të mërkurës, të enjten po tentohet që të futen këto pika në rend të ditës.

Parimisht, pra jemi për marrëveshjet ndërkombëtare, por në këtë rast kërkojmë afat shtesë që të gjithë deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së të kenë afat që t'i analizojnë këto dhe të arrijmë tek një qëndrim i përbashkët i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Prandaj, në këtë rast nuk e përkrahim përfshirjen e tyre në rendin e ditës së sotëm me këtë procedurë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Mustafa! Nga Grupi Multietnik, zoti Artan Asllani.

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Në emër të Grupit Multietnik ne i mbështesim këto pika të rendit të ditës edhe jemi pro ndryshimit të këtyre marrëveshjeve.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Asllani!

Nga AAK-ja Besnik Tahiri, shefi i Grupit.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Ne normal që e mbështesim miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, mirëpo është plotësisht e palogjikshme për marrëveshjet ndërkombëtare që do duhej të ketë kohë, do të duhej të ketë lexim, të vijmë në këtë formë dhe në këtë masë. Kjo do të jetë hera e fundit që na sillni marrëveshjen ndërkombëtare, duke e ditur që ne si Grup Parlamentar, si Aleancë jemi zotuar që i votojmë marrëveshjen ndërkombëtare, por më nuk do të pranojmë asnjë kërkesë në qoftë se paraprakisht nuk e kemi një informacion prej shifes së Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, se s'bëhet nami të dërgoni një mesazh, ta sillni deri te zyra një kërkesë, të thoni ky është qëndrimi ynë. Kjo është hera e fundit që ne e mbështesim një amendamentim të tillë për marrëveshjet ndërkombëtare, për çka kemi thënë që i keni votat tona.

KRYETARJA: Në Kryesi janë njoftuar, anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve që kanë qenë të pranishëm. Në atë moment unë s'kam qenë e pranishme, por zoti Gola që e ka kryesuar atë takim, pra i ka njoftuar vetëm për sqarim. Zonja Nagavci, shkurt të lutem!

ARBËRIE NAGAVCI: E vlerësoj interesimin e deputetëve dhe vullnetin e tyre për kontribut. Për korrektësi, materialet e këtyre marrëveshjeve ne i kemi pranuar si deputetët me i mel që ditën e

premtë. Ndërkohë që edhe në mbledhje të Kryesisë, ditën e hënë unë kam njoftuar të gjithë deputetët, pjesëmarrësit aty që do t'i kërkojmë si shtesë në trajtimin në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARJA: Zoti Tahiri, po! Regjia, zoti Tahiri!

BESNIK TAHIRI: Duhet të jem edhe një herë bukur i saktë çka thashë. Ne sot po amendamentojmë agjendën, të cilën e kemi marrë dhe e kemi ndarë, unë e kam ndarë me kolegët e mi të grupit parlamentar. Këto pika nuk janë në këtë agjendë. Ju e dini që ne jemi zotuar dhe nuk kemi ndërruar qëndrim për marrëveshjet ndërkombëtare, ne do t'i votojmë.

Marrëveshjet ndërkombëtare në vete përmbajnë çështje që duhet një zyrtar i zgjedhur, në këtë rast një deputet i zgjedhur t'i lexojë. Unë kam pasur mbledhje me grupin tim parlamentar, jemi dakorduar çka mbështesim, çka nuk mbështesim, cilët persona i çojmë në grupe punuese dhe këto nuk i kemi.

Thashë edhe një herë, nuk është edhe nuk duhet të lejohet kjo praktikë në moment të fundit të sillen marrëveshje ndërkombëtare, vetëm në qoftë se është ndonjë çështje bukur problematike sikur që ka qenë marrëveshja me Bankën Botërore, që i ka skaduar afati po atë ditë, në rregull është të ndodhë ajo. Po jo të futen në këtë mënyrë, në këtë formë. Nuk e kemi pasur këtë agjendë në grupin tonë parlamentar dhe nuk ka qenë e diskutuar.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri!

Po vazhdojmë me votimin për përfshirjen në rend të ditës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

Vazhdojmë së pari me: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/ L-015 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe e Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e zhvillimit të sektorit financiar të Kosovës.

Kërkohet nga grupet parlamentare që të përgatiten për votim. Votojmë tash, pra për përfshirje në rend të ditës.

Konstatohet që përfshihet kjo marrëveshje në rendin e ditës së seancës së sotme. 91 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, një abstenim.

Vazhdojmë me marrëveshjen e radhës: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/ L- 016 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për programin e kredisë së bazuar në politika.

Atëherë përgatitemi për votim, votojmë tash!

Vetëm për sqarim, po kërkohet që të përsëritet votimi. Megjithatë 71 deputetë kanë votuar për, ju lutem regjia dhe një herë të më njoftojnë për rezultatin. 71 për, me sa pashë unë dhe asnjë kundër, asnjë abstenim. Regjia, ju lutem që mos e hiqni menjëherë nga ekrani.

Vetëm për njoftim, shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes propozoi katër marrëveshje që të përfshihen në rendin e ditës. I lexoi secilën prej tyre, e dëgjova me vëmendje dhe pastaj nuk mund t'i vendosim të gjitha bashkërisht, por veç e veç. Marrëveshja e parë kaloi, kaloi edhe marrëveshja e dytë dhe tash jemi në të tretën. Nëse keni nevojë për sqarime shtesë, jam e gatshme që t'ju jap.

Unë deklaroj që vullneti i PDK-së ka qenë për ta përfshirë edhe këtë marrëveshje, por që kanë pasur mungesë të informacionit ose kanë kërkuar sqarime shtesë në raport me procedurat. Besoj që është në rregull.

Vazhdojmë me marrëveshjen e tretë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-017 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave KF Frankfurt am Main për programin e kredisë së bazuar në politika në sektorin e energjisë dhe klimës për Kosovën.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

89 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, një abstenim.

Vazhdojmë edhe me propozimin e fundit të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-018 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin "Lehtësimi i tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0."

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

89 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Konsiderohet që edhe kjo pikë u përfshi në rendin e ditës së seancës së sotme.

Tani unë kam para vetes edhe një propozim për ndryshim të rendit ditës që është nga Grupi Parlamentar i PDK-së, që është: Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për mbrojtjen e së vërtetës historike të luftës në Kosovë 1998-1999.

Ftoj përfaqësuesin nga PDK-ja, zoti Përparim apo zonja nënkryetarja Çitaku. Regjia, ju lutem!

VLORA ÇITAKU: Kryetare!

Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar ka përgatitur një draft rezolutë, të cilën e kemi proceduar në Kuvendin e Kosovës në mbrojtje të së vërtetës dhe dinjitetit të viktimave të luftës. Sot përballë nesh nuk kemi vetëm sfida politike apo institucionale, kemi një sfidë edhe më të thellë dhe më të rrezikshme, përpjekjen për ta shtrembëruar historinë tonë. Kujtesa nuk është vetëm e kaluar. Kujtesa është identitet, është themeli mbi të cilin qëndrojmë ne si shoqëri.

Ne kemi dhënë një draft propozim, e nderuar kryetare, jemi të gatshëm ta diskutojmë. Kërkojmë të futet në rendin e ditës si pikë e parë, menjëherë pas pyetjeve parlamentare. Nuk ka kuptim që Kuvendi sot të silltet normalisht dhe mos ta miratojë këtë rezolutë si hap i parë. Jemi të hapur për diskutim, për plotësime, mirëpo për PDK-në është e domosdoshme që kjo rezolutë të hyjë në rend të ditës dhe të jetë pika e parë që trajtohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja nënkryetare Çitaku!

Tani radha është e grupeve parlamentare. Ftoj Lëvizjen Vetëvendosje, përkatësisht shefen e grupit, zonjën Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

E nderuar kryetare, faleminderit.

Ashtu sikurse diskutuam edhe në takimin e Kryesisë bashkë me shefat e grupeve parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje është e interesuar, e gatshme të kontribuojë në një rezolutë, e cila do të paraqiste përmbajtjesisht dhe në aspekt shumëdimensional çështjet që trajtojnë luftën e fundit. Në lidhje me këtë ne jemi të gatshëm që të delegojmë deputetët tonë, sikurse biseduam edhe në takim, që bashkë me deputetët e grupeve të tjera parlamentare të punojnë gjatë ditës dhe të vijnë me një rezolutë, e cila i adreson këto çështje në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu siç pritet edhe nga Kuvendi.

Pra, ne jemi të gatshëm të dërgojmë deputetët tanë si pjesë e një grupi të përbashkët me përfaqësuesit e të gjitha partive dhe deri në fund të ditës të sjellim një draft për të miratuar në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARJA: Vetëm ju lutem që në ndërkohë derisa të flasin shefat e grupeve të dakordoheni edhe një herë. Pajtoheni që të mbliidhen grupet parlamentare, nëse ju kuptova drejt, përkatësisht përfaqësues nga grupet parlamentare që të diskutojnë tekstin e rezolutës.

PDK-ja propozoi që kjo pikë të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës pas pyetjeve parlamentare, në anën tjetër, sipas asaj që tha zonja Nagavci që kjo të radhitet si pikë e fundit e

rendit të ditës. Pra, kemi qëndrime të dy grupeve parlamentare, tash i dëgjojmë edhe grupet e tjera parlamentare. Uroj që derisa të vijmë sërish që të kthehemi pas fjalës së grupeve parlamentare të kemi një dakordim edhe ndërmjet vetë grupeve parlamentare. Besoj që është e rëndësishme që të jemi të unifikuar në raport me këtë çështje që unë e shoh që është teknike, sepse a është e para, a është e fundit, ne do ta trajtojmë megjithatë sot. Faleminderit!

Zonja Lushaku!

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Faleminderit!

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar tekstin e rezolutës edhe në parim pajtohem për të, sepse mendojmë që është obligimi joni edhe institucional, edhe shtetëror për ta mbrojtur të vërtetën edhe sakrificën e popullit tonë për liri.

Gjithsesi jemi të gatshëm të kontribuojmë edhe në komision të përbashkët nëse ka një iniciativë të tillë për ta modifikuar edhe për ta plotësuar tekstin e kësaj rezolute.

Faleminderit!

KRYETARJA: Zonja Lushaku, më falni, a e propozuat, domethënë, a e përmendët çështjen se ku të radhitet, në fillim apo në fund?

S'ka, s'ka rëndësi. E kuptoj qartë. Faleminderit. Faleminderit, vetëm për sqarim sepse po na duhet që të kemi një koordinim sa më të mirë. Pra, LDK-ja është e hapur në raport e para apo e fundit.

Tani vazhdojmë me zotin Asllani. Ju lutem, zoti Asllani, fjala është për ju.

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Ne duam të jemi shumë të qartë lidhje me këtë. Mbrojtja e të vërtetës së historisë së luftës është obligim i përbashkët dhe unë dua që edhe të ndahet me të gjithë ne dhe me Grupin Multietnik. E pikërisht për shkak të kësaj rëndësie konsideroj se kjo rezolutë nuk duhet të trajtohet me një urgjencë dhe me reagim ndaj momentit, por duhet të jetë një dokument, i cili ka gjithë përfshirje, e rregullon mirë këtë çështje.

Kështu që ne jemi të gatshëm të kontribuojmë, jemi të gatshëm që të punojmë në këtë drejtim, edhe mendoj që duhet të kemi kohën e mjaftueshme që sot gjatë ditës kjo të votohet. E për shkak të kësaj nuk besoj që duhet të jetë pikë e parë e rendit të ditës, po duhet vendosur më poshtë që të ketë hapësirën edhe kohën e duhur të punës.

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu, zoti Asllani. Tani e ka fjalën shefi i Grupit të AAK-së, zoti Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, po u drejtohem edhe qytetarëve të Kosovës që ta sqaroj pak rrjedhën e këtij procesi.

Ne këtë draft-rezolutë të propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së e kemi marrë dje si draft, të gjithë ne grupet parlamentare. Kemi pasur bukur një kohë për ta shqyrtuar, për ta trajtuar, me sa e di unë, unë i kam dërguar dy komente, kanë qenë edhe disa komente të tjera.

Sot kemi pasur një takim në mëngjes, për hir të transparencës po e them, ku kemi diskutuar për nevojën që përmbajtja të jetë pak a shumë e përbashkët. Se a ka apo jo nevojë për të pasur një rezolutë, për mendimin tim, ky Kuvend edhe kjo histori e Kosovës realisht është e pandryshueshme. Mirëpo, rrethanat në të cilat është sot Kosova dhe është sot Kuvendi i Kosovës na obligon që të kemi një qëndrim për një çështje bukur të rëndësishme.

Propozimi im është që po ashtu të jetë në rendi të ditës si pikë e parë. Ne e kemi një kohë që do të kemi pikën e parë të rendit të ditës që është: hajt pak, apo më mirë të them deklaratime jashtë rendit të ditës. Mund ta marrim edhe një kohë, se ashtu-kështu u vonuam diku një orë derisa ia nisëm kësaj seance. Nuk besoj që këtu ka nevojë për një shkencë të madhe; e merr një grup punues që përfaqësohet prej grupeve tona parlamentare, ulen diskutojnë në një sallë, salla ka boll, një orë a një orë e gjysmë dhe e vendosim si pikë të parë dhe e heqim nga rendi i ditës pa debat.

Nuk është mirë të rikthehet debati në këtë Kuvend për një çështje që është emblematike, historike, po duhet vetë të japë një zotim, i cili, në esencë, nuk buron, nuk krijon ndonjë obligim, por vetëm është një deklaratë.

Prandaj, propozimi im është ta vendosim në pikën e parë, të vazhdojmë me çështjet që janë: me deklaratime jashtë rendit të ditës. Në qoftë se nuk mund ta kryejmë për një orë, se ashtu zgjat debati, atëherë t'i jepet edhe një gjysmë ore, edhe të vazhdojë punimet, për shkak se i kemi edhe disa marrëveshje ndërkombëtare, disa pika për të cilat jemi zotuar ne të jemi prezentë. Besoj që është e rëndësishme dhe mos ta komplikojmë një çështje që është e panevojshme të komplikohet. Merreni një orë e gjysmë, vazhdojmë me pikë të parë, diskutojmë, edhe e përmbyllem këtë temë, mos ta mbajmë pezull. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit z. Tahiri!

Në këtë pikë, duke ju dëgjuar me vëmendje në raport me atë çfarë deklaruat, konsideroj që është shumë e rëndësishme që të ketë unifikim në raport me këtë çështje.

Ne për herë të parë kemi edhe Ministrinë për Vlerat e Luftës. Ministrin Hoti e kemi këtu. Prandaj, unë mendoj që diskutimi për një draft-rezolutë që do të procedohet si harmonizim, si të

them, nga të gjitha grupet parlamentare, me kontributin e të gjitha grupeve parlamentare, siç ka ndodhur edhe në të kaluarën, sepse sa herë është propozuar ndonjë rezolutë, paraprakisht është diskutuar me të gjitha grupet parlamentare. Pra, do t'i shërbente edhe kontributi dhe ndihma që do ta jepte ministri Andin Hoti.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë që ka kjo çështje, si kryetare e Kuvendit ju lus që të jeni të unifikuar, sepse po e shoh që dallimi nuk është i madh. A vendoset në fillim të rendit të ditës a në fund, besoj që ata që përnjëmend mendojnë që kjo çështje është shumë serioze, qëllimin duhet ta kenë që të kalojë rezoluta dhe jo a vendoset pika e tretë, a e dytë.

Ju lutem si kryetare e Kuvendit që t'u jepni hapësirë diskutimeve, të mos e paragjykojmë; ndoshta përmbillet për një orë, ndoshta për dy orë, ndoshta për tri orë, por që le të vazhdojnë përfaqësuesit e grupeve të diskutojnë për këtë çështje dhe më pas na sjellin një draft të rezolutës.

Zonja Çitaku!

VLORA ÇITAKU: Kryetare!

Grupet parlamentare, të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës e kanë pranuar tekstin e rezolutës dje. Është deponuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ka pasur kohë të mjaftueshme! Ka pasur kohë të mjaftueshme që grupet parlamentare të japin vërejtjet e tyre. Megjithatë, ne jemi të gatshëm që të ulemi bashkë, sepse për ne, po besoj për secilin deputet që është sot këtu, nuk ka bash asnjë çështje tjetër më të rëndësishme se trajtimi i kësaj rezolute, votimi në unanimitet.

Ne jemi të gatshëm të ulemi, të takohemi, të inkorporojmë vërejtjet, por nuk jemi të gatshëm të bëjmë kompromis, sepse ne jua dhamë votat. Kryetare, jua dhamë votat për marrëveshjet ndërkombëtare, do t'i votojë marrëveshjet ndërkombëtare! Po ky tekst, kjo rezolutë në mbrojtje të së vërtetës historike, në mbrojtje të viktimit është më e rëndësishme se çdo marrëveshje ndërkombëtare.

Ju lutem, kryetare, tjetër punë ne nuk kemi, deputetë jemi, rrimë këtu edhe dy orë, edhe pesë orë. Ta kryejmë sot, edhe ta kryejmë si pikë të parë të rendit të ditës. Kjo është kërkesa jonë!

KRYETARJA: Faleminderit!

Kjo kërkesë është adresuar e proceduar dje pasdite në Kuvendin e Kosovës, por që Administrata e ka pasur të pamundshme ta shpërndajë te deputetët e Kuvendit. Atë e kanë pasur vetëm disa.

Ju lutem, vetëm për sqarim!

Atë e kanë parë vetëm disa me të cilët jemi konsultuar. Për hir të sqarimeve, në raport me opinionin publik, unë kam pasur një takim sot me anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve

parlamentare në orën 9:00 në kabinetin tim. Kemi diskutuar për këtë çështje. Në parim, jemi pajtuar. Unë mendoj që është dashur që të vazhdojmë në frymën e atij takimi që kemi pasur në mëngjes, pra së bashku.

Në këtë drejtim, pika që është propozuar nuk e definojnë a është pikë e parë a pikë e dytë e rendit të ditës. Pra, kërkesa që PDK ka parashtruar nuk kërkon që të jetë a të radhitet si pikë e parë e rendit të ditës. Prandaj, vetëm ta sqarojmë! Prandaj, nëse kërkesa formale që është proceduar në Kuvend të Kosovës nuk e thotë këtë, atëherë ju lutem që ta bëjmë kështu siç keni thënë, vetëm që pas dakordimeve nga grupet parlamentare, kurdo që të përfundojnë, pastaj vijmë dhe e diskutojmë sërish.

Unë po përpiqem vetëm që më jap zgjidhje. Përndryshe, unë detyrohem që të vendos propozimin tuaj në votim dhe çka mbërrin pastaj. Prandaj, ju lutem! Po ju jap edhe një hapësirë që ta konsideroni kërkesën time, jo tash të Vetëvendosjes; kërkesën time si kryetare e Kuvendit.

Zonja Çitaku!

VLORA ÇITAKU: Rregullorja më lejon që të bëj propozim edhe tani. Unë tani po propozoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që kjo të jetë pikë e parë e rendit të ditës. Nuk ka fije kuptimi që ne të trajtojmë çështje të tjera sot pa e votuar këtë rezolutë. Po e them shumë sinqerisht, vonë jemi! Duhet ta bëjmë menjëherë!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Çitaku!

Znj. Nagavci e dëshiron fjalën dhe pastaj vazhdojmë me votimin, nëse të tjerë s'ka të paraqitur për fjalë.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Ashtu sikurse e thanë dhe pajtohemi se është një çështje, e cila ia vlen të diskutohet në Kuvend, por po ashtu kjo rezolutë do të duhej të reflektonte unitetin politik dhe ndërpartiak. Për më shumë, Kuvendi si institucioni më i lartë i vendit nuk mund të trajtohet si një institucion, i cili vetëm miraton një rezolutë sa për të shprehur një deklaram politik.

Duhet të sigurohemi që çështjet e rëndësishme adresohen aty dhe ne si grup parlamentar jemi të gatshëm dhe të interesuar që bashkë me përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare, të ulemi dhe të diskutojmë që të kemi një rezolutë përbashkuese në lidhje me këtë temë.

KRYETARJA: Ju lutem, shefat e grupeve parlamentare të vini veç një minutë për konsultim, para se të vendosim për të votuar. Ju lutem znj. Çitaku ose z. Tahiri, Arbërie Nagavci, Jehona Lushaku, Besnik, Artan!

(Pauzë)

Ju lutem që t'i zini vendet tuaja! Ju faleminderit!

Duket që konsultimi ishte i pasuksesshëm. Unë propozova që të mblidhen përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe kurdo që ata e përmbyllin punën dhe e finalizojnë draftin, ta sjellin, por që PDK-ja po insiston vetëm si pikë të parë të rendit të ditës. Prandaj, në këto rrethana, obligohem që ta hedh në votim.

Ftoj deputetët që të vijnë në sallë!

Znj. Çitaku, po të lutem!

VLORA ÇITAKU: Kryetare!

Propozimi ynë është i qartë: të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës!

Rregullorja ma jep të drejtën që të bëj këtë propozim. Nuk do të ishte as hera e parë, as hera e fundit që ndryshon radhitja e pikave të rendit të ditës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në rast se, në rast se nuk kalon si pikë e parë, ne e tërheqim propozimin dhe largohemi.

KRYETARJA: Zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Pra, edhe një herë kryetare! Ne jemi të interesuar që të kontribuojmë. Propozimi ynë është, ashtu siç e thamë, le të mblidhet grupi me përfaqësues të të gjitha partive politike. Në momentin që grupi e sjell rezolutën, ne në atë moment që e sjellin e vendosim në votim.

KRYETARJA: Pra, në këto rrethana, zonja Çitaku, e tërhiqni propozimin apo ta vendos votim? Zonjës Çitaku, fjalën!

VLORA ÇITAKU: Në një situatë të tillë kur ka mungesë të shprehur të vullnetit politik për të bërë një kompromis për një çështje kaq të ndjeshme, në të njëjtën ditë kur ne si opozitë jua votuam hyrjen në rend të ditës të marrëveshjeve ndërkombëtare, është tërësisht e pakuptimtë për ne që ta hedhim në votim propozimin tonë. Ne do të largohemi nga salla. Në sallë do të qëndrojmë vetëm zoti Nait Hasani, i cili do të flasë pastaj dhe do të deklarohet në emër të grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Çitaku! Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. Grupi parlamentar e tërheq propozimin. E kanë tërhequr. Vazhdojmë me seancën. Në sallë janë të pranishëm... Për pak e konstatojmë se sa deputetë janë të pranishëm në sallë.

Ju lutem deputetë që t'i zini vendet tuaja! Atëherë përgatitemi për votim për prezencë.

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Regjia, ju lutem! 81 deputetë janë në sallë. Pyes nëse keni vërejtje në... Ju lutem që të mbani qetësi! Deputetë të nderuar, ju lutem që të mbani qetësi!

Nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 11, 12, 13, 16 deri 20 shkurt 2026. A ka vërejtje në këto procesverbale? Nëse jo, konsiderohet që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 11, 12, 13, 16 dhe 20 shkurt 2026.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Koha për deklarinimin jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 40 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta. Diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim paraprakisht duhet të deklarohen se në çfarë cilësie kërkojnë fjalën. Prandaj, po vazhdojmë me grupet parlamentare. Zonja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Rifillimi i punës së Kuvendit pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese është një moment që kërkon qartësi, seriozitet dhe përgjegjësi. Jemi rikthyer, jo vetëm në formalitetin e rendit të ditës, por në thelbin e funksionit tonë si përfaqësues të qytetarëve.

Kuvendi i Republikës është vendi ku merren vendimet. Nuk ka asnjë adresë tjetër ku mund të zhvendoset kjo përgjegjësi. Në këtë fazë kemi nevojë për unitet dhe për bashkëpunim. Para nesh e kemi një proces të rëndësishëm kushtetues, zgjedhja e presidentit të Republikës. Nga secila e secili prej nesh kërkohet pjekuri politike. Nën emrin e çdo deputeti nënshkruhet serioziteti i këtij institucioni.

Presidenti si figurë e unitetit të popullit thërret për proces që duhet të udhëhiqet nga fryma e bashkëpunimit. Përgjegjësia është e jona, nuk mund të zhvendoset. Nuk mund të shtyhet dhe nuk mund të relativizohet. Qytetarët presin nga ne që të marrim vendime. Edhe ata që mendojnë e punojnë për zgjedhje duhet ta dinë se zgjedhjet nuk na e heqin përgjegjësinë për të bashkëpunuar për të njëjtat tema herët apo më vonë. E në këto kushte, më mirë tani sesa më vonë.

Sot kemi një rend të ditës me rëndësi për vendin, marrëveshjet ndërkombëtare që presim votim janë të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe për besueshmërinë tonë në arenën

ndërkombëtare. Besoj dhe pres në bashkëpunimin tonë. Le të qëndrojmë të palëkundur pro interesit më të lartë, atë të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kjo periudhë e vitit na rikthen te kujtesa jonë kolektive. Pranvera për ne është një kohë reflektimi për sakrificën mbi të cilën është ndërtuar Republika jonë. Ne përulemi me respekt para dëshmorëve dhe kujtojmë me dhimbje viktimat e luftës, të cilët e paguan çmimin më të lartë për lirinë.

Kjo kujtesë nuk duhet të mbetet vetëm në fjalë apo në ceremoni. Ajo duhet të reflektohet në mënyrën se si ne veprojmë, në vendimet që marrim dhe në seriozitetin me të cilin e trajtojmë përgjegjësinë tonë. Harresa për sakrificën komprometon drejtimin që merr shteti e shoqëria. Në këtë kontekst, debatet e fundit lidhur me këtë temë na dëshmojnë se sa e ndjeshme mbetet çështja e kujtesës sonë historike. Ne jemi shoqëri demokratike dhe debati është i domosdoshëm, por ky debat duhet të jetë i përgjegjshëm, i bazuar në fakte dhe i zhvilluar me respekt të veçantë për të vërtetën, mbi metoda shkencore, mbi të gjitha, me një respekt të thellë për ndjenjat dhe vuajtjet e jashtëzakonshme të qytetarëve tanë. Sa herë veprojmë si përfaqësues politikë e institucional, na duhet të mos harrojmë lotët ende të patharë në çdo familje tonë.

Lufta jonë çlirimtare është një fakt historik dhe moral që nuk mund të relativizohet. Kjo nuk e përjashton nevojën për reflektim dhe për diskutim, por e vendos atë në një kornizë të qartë të përgjegjësisë. Në këtë kuptim, është vendi edhe për një thirrje që secili e kushdo që ka të dhëna të bashkëpunojë me Institutin për Krimet e Luftës.

Veprimet tona për këto vite lidhur me dokumentimin e krimeve të luftës janë iniciuar me qëllim të mirë e në mirëbesim të kauzës së përbashkët që e kemi si shoqëri. Nuk duhet të ndalemi në asnjë rrethanë deri në kompletimin e dokumentimit për çdo ngjarje të dhimbshme të vendit tonë, përfshirë kërkimin për vendosjen e drejtësisë për çdo masakër, krim lufte e gjenocidin e kryer nga Serbia në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Qytetarët nuk presin nga ne justifikime, por rezultate. Ata presin që Kuvendi të jetë funksional, vendimmarrës dhe në shërbim të interesit publik. Dhe kjo është ajo që ne si deputet duhet të bëjmë. Le të tregojmë se jemi në lartësinë e përgjegjësisë që kemi marrë. Le të veprojmë me qartësi, me maturi dhe me vendosmëri. Faleminderit!

KRYETARJA: Pesë minuta rrafsh, zonja Nahavci! Tani radha është e deputetit Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Përshëndetje, nderuar kryetare!

Flas në emër të Grupit të Partisë Demokratike. Sot këtu nuk po flas vetëm si deputet, sot po flas si dëshmitar i masakrës në Burgun e Dubravës. Si njeri prej atyre që kanë qenë brenda Burgut të Dubravës dhe në burgjet e Serbisë. Si njeri që e kam parë me sytë e mi çfarë ka bërë shteti serb mbi trupat dhe jetën tonë aty brenda burgut ndaj të burgosurve, dhe pikërisht për këtë sot jam këtu për të thënë një të vërtetë të rëndë.

Ajo që është prezantuar në këtë ekspozitë më 24 mars 2026 nuk është vetëm gabim, është prezantim i qëllimshëm i deklarimeve të UDB-së së asaj kohe. Kjo është fyerje për viktimat, është fyerje për të burgosurit dhe të mbijetuarit, është fyerje për të vërtetën e masakrës në Burgun e Dubravës. Sepse, kur në libër e në ekspozitë të financuar nga institucionet shtetërore dhe paraja publike për masakrën e Burgut të Dubravës, ku thuhet se në atë masakër ka pasur kryengritje, janë vrarë 48 ushtarë të burgosur dhe të armatosur dhe 58 civilë, nuk e ka treguar të vërtetën. Ai ka prezantuar sot pas 27 vjetësh masakrën e Burgut të Dubravës në sheshin e Prishtinës, propagandën e aparatit kriminal serb mbi masakrën në Burgun e Dubravës.

Në shtator të vitit 2024, në Shtëpinë e mediave në Prishtinë, në aktivitete të organizuar nga Birn-Kosova dhe Jeta Xharra, në debatin publik ka qenë prezent fotoreporterit serb, Goran Tomasheviq, ish-oficer rezervë.

Është thënë se policia serbe, respektivisht Zyra e informacionit e ka njoftuar Qendrën e mediave se në Burgun e Dubravës ka pasur rebelim të të burgosurve shqiptarë dhe se gardianët janë detyruar të intervenojnë për ta shuar rebelimin e të burgosurve të armatosur shqiptarë, dhe këtë, sipas fotoreporterit, ai e ka prezantuar në të gjitha mediat e botës si kryengritje e të burgosurve të armatosur në Burgun e Dubravës. Kjo deklaratë flet për rrëfimet e rreme të fotoreporterit serb.

Unë, Enver Dugolli dhe Sadik Zeqiri, kemi kundërshtuar për prezantimin e një të pavërtetë mbi masakrën e Burgut të Dubravës. Ai më pas kërkoi falje, por kjo është e pamjaftueshme, sepse dëmi politik është bërë me prezantimin e versionit të UDB-së. Sepse, po të kishte pasur qëllim të prezantonte të vërtetën për masakrën në Burgun e Dubravës, ka pasur mundësi të shkojë atje dhe të shohë obeliskun me emrat e mbiemrat e vrarëve, të plagosurve dhe të burgosurve që ishin aty në atë kohë, ose ka mundur të shkojë te Shoqata të Burgosurve të marrë shënime mbi Burgun të Dubravës. apo në Këshillin për Mbrojtjen të Drejtave të Njeriut, ose në cilindo, ku mbi 700 të burgosur ka mundur t'i intervistojë. Por, ai nuk e ka bërë. Nuk ka pasur qëllim ta prezantojë të vërtetën në ekspozitë, por versioni i UDB-ës ka prezantuar diçka që është e tmerrshme.

Ndërkaq, liria e shprehjes dhe veprimtari nuk përfshin të drejtën për të falsifikuar krijimet serbe dhe të fajësohen viktimat. Kjo ekspozitë e integrove dhe admove është me pasoja të rënda politike për Kosovën dhe për krimet serbe të bëra në Kosovë. Kërkim-falja e Shkëlzenit nuk e riparoi dëmin e shkaktuar për shtetin tonë dhe për të vërtetën e masakrës së Burgut të Dubravës.

Për më keq, këtë version të UDB-së deshi t'ia mveshë Fondit për të Drejtat Humanitare të Natasha Kandiç, e cila dëmtoi dhe mohoi një version të tillë. Natasha thotë se dhe në Serbi nuk është thënë që të vrarët në Burgun e Dubravës ishin të armatosur.

Unë kam qenë i burgosur aty. Ne kemi qenë 960 të burgosur dhe në burg nuk ka pasur ushtarë, nuk ka pasur beteja, nuk ka pasur kryengritje, aty ka pasur vetëm të burgosur shqiptarë dhe dhunë e vrasja të shtetit serb mbi shqiptarët e pambrojtur.

Në Dubravë ka pasur masakër të shtetit mbi të burgosur nga gardianë, policë, ushtarë dhe të burgosur serbë. Të gjithë të organizuar kanë hapur zjarr nga të gjitha anët më 22 e 23 maj 1999 mbi të burgosurit shqiptarë. Aty janë vrarë njerëz e paarmatosur nga mosha 17 deri në 60 vjeç dhe është 1 i zhdukur, ai është Ukshin Hoti. Janë ekzekutuar njerëz që nuk kishin asnjë mundësi mbrojtjeje, të cilët në bazë të konventave ndërkombëtare do të duhej të mbroheshin nga shteti.

Sot, në shtetin tonë na paraqitet një ekspozitë në Prishtinë, duke prezantuar versionin e UDB-së për masakrat në Kosovë, e në veçanti për masakrën në Burgun e Dubravës. Kjo nuk është vetëm e papranueshme, kjo është e turpshme dhe e dhimbshme për familjet e tyre dhe për ne të burgosurit.

Po e them qartë, kushdo që e ka bërë këtë dhe e mbështet këtë veper të tij është duke i bërë një shërbim direkt Beogradit dhe Vuçiqit. Këtë ma dëshmon angazhimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Regjia, ju lutem edhe një minutë zotit Hasani! Dy minuta po kërkon zoti Hasani.

NAIT HASANI: Këtë ma dëshmon angazhimi i tij i vazhdueshëm kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku thotë se Dik Marti është një shqiptar i mirë. Në versionin e tij, ai ka mbledhur dëshmi kundër UÇK-së për trafikim organesh. Ndërsa, Shkëlzeni thotë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka vrarë civilë. Ndërkaq, për të vërtetën tonë flasim meqenëse mediave të Kosovës.

Për heronjtë kombëtarë me të cilët ne jemi rritur, jemi edukuar, jemi frymëzuar për luftën dhe betejat çlirimtare të Isa Boletinit, njeriu i cili e ka puthur flamurin e pavarësisë pranë Ismail Qemalit në Vlorë, Shkëlzeni e quan mercenar të Serbisë.

Unë sot u drejtohem drejtpërdrejt organizatorëve për ekspozitën dhe mendësisë së tyre se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë çlirimtare, është çlirimtare, e pastër, dhe së bashku me NATO-n dhe SHBA-të, ia ka sjellë lirinë Kosovës.

Kërkoj publikisht pa asnjë kompromis që asnjëherë të mos shfaqen ekspozita të tilla me përmbajtje të rreme, që ky të mbahet përgjegjës për ekspozitën, mashtrimin e institucioneve, dhe të organeve të drejtësisë që ta kryejnë punën e vet sipas ligjit.

Të nxirret një ligj për mbrojtjen e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të krijuara me mund gjak sakrificë mbinjerëzore. Nëse ne nuk e mbrojmë të vërtetën tonë, askush nuk do të na mbrojë neve. Nëse ne lejojmë që historia jonë të shkruhet nga propaganda serbe, e atyre që kanë kryer krime në Kosovë, atëherë ne kemi dështuar si shtet. Ne e dimë se çfarë ka ndodhur në Burgun të Dubravës dhe ne nuk do të lejojmë që masakrat e tilla të masakrohen për herë të dytë nga mercenarët shqiptarë.

Ne si Grup Parlamentar i PDK-së dhe unë si ish-burgosur dhe i mbijetuar i masakrës së Burgut të Dubravës e kundërshtojmë këtë narrativë serbe të paraqitur nga Shkëlzeni me ekspozitën e tij në Sheshin Nëna Terezë. Lavdi të rënëve në Burgun e Dubravës dhe të të gjithë të rënëve në Kosovë! Faleminderit!

Ne kemi libër që dëshmon mbi masakrën. Ka mundur ta kërkojë. Kemi pasur kallëzim penal në gjykatë, në prokurori prej vitit 2007. Ka mundur të kërkojë. Kemi rezolutë që është miratuar për kri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Hasani! Tani është radha e LDK-së. Zonja Lushaku, fjala është për ju.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Do ta ngre një çështje tepër të rëndësishme për secilën familje të Kosovës. Një çështje që ka të bëjë me një mashtrim nëpërmjet një keqlllogaritje të shpenzimit të energjisë elektrike. E prek secilin prej nesh dhe familjet tona. Është një padrejtësi që po bëhet për muaj, apo vite me radhë.

Teksa kemi dëgjuar Qeverinë që u ka bërë thirrje qytetarëve ta kursejnë energjinë elektrike e të presin e të shpenzojnë prej orës 22:00 për shpenzim të energjisë me të lirë, ne sot kemi parë që shumica e njësorëve nuk e llogaritin saktë shpenzimin e energjisë, dhe kjo çon tek llogaritja më e madhe dhe faturimi më i shtrenjtë për secilën familje të Kosovës.

Ky shqetësim është ngritur publikisht pas verifikimeve konkrete në terren të qindra njësorëve elektrikë, të bërë në kuadër të angazhimit të anëtarit tonë Visar Azemi dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në këto verifikime del se një përqindje dërrmuese, pra mbi 87% e njësorëve elektrikë e matin kohën gabimisht. Pra, qytetarët janë mashtruar. Qeveria u ka thënë kurseni rrymën, shpenzoni në orët e natës derisa orët kanë keqlllogaritur. Kjo është e vërteta e hidhur. Edhe pikërisht këtu lindin shumë pyetje. Si është e mundur që një problem i tillë të jetë kaq i përhapur dhe Ministria e Industrisë të mos ketë vepruar me kohë?

Si është e mundur që qytetarët të kenë paguar për muaj të tërë, e ndoshta dhe për vite fatura të padrejta me keqlllogaritje edhe ministria dhe institucionet e tjera nuk janë thirrur për përgjegjësi? Dhe, ky fenomen nuk është i izoluar, por është i përhapur masivisht te çdo familje. Përgjegjësia në këtë rast është e qartë dhe nuk mund të shmanget.

Ministria e Industrisë, KEDS-i, ZRRE, KESCO mbajnë përgjegjësi për mosveprim edhe për dështim për të garantuar mbrojtjen e qytetarëve në çdo çështje që prek drejtpërdrejt faturimin e energjisë elektrike.

Nëse për muaj, e ndoshta dhe për vite qytetarët janë dëmtuar nga ky sistem i padrejtë faturimi, atëherë Ministria e Industrisë nuk mund të sillet si spektatore. Ka obligime të reagojë dhe të mbikëqyrë gjithë këtë dhe të japë llogari. Dëmi nuk është individual, ai prek çdo familje. Vetë ZRRE-ja ka pas marrë vendim dhe ka definuar që orët ku llogaritet energjia elektrike me të lirë, verës janë në orën 23:00 e dimrit në orën 22:00. Por, ajo që shohim është krejt tjetër, llogaritja është totalisht anarkike në njësorë.

Në të njëjtën kohë është e papranueshme që diskutohet për rritje çmimesh të energjisë në një situatë kur vetë sistemi zyrtar i faturimit është vënë në pikëpyetje.

Nuk mund të kërkosh më shumë nga qytetari kur nuk i garanton as drejtësinë minimale sot. Prandaj, LDK kërkon sot shumë qartë: hetim të pavarur dhe auditim të plotë të sistemit të faturimit. Dorëheqje të Bordit të ZRRE-së, kompensim për çdo qytetarë e për çdo centë të marrë padrejtësisht, ndërprerje të menjëhershme të çdo diskutimi për rritjen e çmimit të energjisë dhe hetim nga Prokuroria dhe përgjegjësi penale. Normalisht, që kjo duhet t'i faturohet qeverisë si një dështim, për të cilën i kërkojmë llogari dhe raport.

Në fund dua t'u drejtohem drejtpërdrejt qytetarëve të Kosovës: mos pranoni këtë si fenomen normal. Mos mendoni që kjo është diçka që nuk mund të ndryshohet. Kontrolloni njësorët tuaj, krahasoni kohën, kërkoni llogari, sepse vetëm një qytetar që kërkon të drejtën, mund ta mbrojë atë. Shteti matet edhe me mënyrën se si i trajton qytetarët e vet, posaçërisht. Edhe sot fatkeqësisht qytetari i Kosovës nuk është duke u trajtuar me drejtësi. Kjo duhet të ndryshojë menjëherë. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Lushaku. Tani e ka radhën Lista serbe, Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajuća,

Poštavane kolege poslanici, danas smo kao parlamentarna grupa želeli da skrenemo pažnju ministru infrastrukture na katastrofalna oštećenja dela magistralnog puta Jarinja-Leposavić, Leposavić-Mitrovica, magistralni put koji je do pre tri godine bio u dobrom stanju jer se na vreme i adekvatno sanirao i održavao, ali od pre tri godine, otkada je Ministarstvo infrastrukture preuzelo odgovornost za vodi brigu o ovom putnom pravcu preko neke kompanije o kojoj ne znamo zašto je o kojoj se radi, dakle, put je u veoma lošem stanju, posebno je u lošem stanju i u prošloj i u ovoj godini gde se potpuno raspada kompletna putna infrastruktura. Ja sam sasvim siguran da se nalazimo u nekom delu Evrope gde nadležne institucije i organi rade svoj posao, sasvim sam siguran da bi ovaj putni pravac bio stavljen van upotrebe dok se on u potpunosti ne sanira i ne sredi.

Mi smo kao poslanička grupa želeli da govorimo o ovoj temi i u prošloj godini, ali pošto smo odmah nakon konstituisanja skupštine imali blokadu institucija, zatim smo imali i prevremene parlamentarne izbore, nije postojala prilika da govorimo o ovoj gorućoj temi. Žao mi je što ministar infrastrukture nije ovde, ali je gospodin Kurti ovde i nadam se da će da čuje ovaj problem, jer ovo je odgovornost i Ministarstva infrastrukture i ministarstva vlade. Dakle, odnosno vlade na čijem čelu je gospodin Kurti.

Radi se o deonici puta čija je dužina 52 kilometra, na čijoj deonici su vidna oštećenja na asfaltu, gde ne postoji ni signalizacija, gde put takođe nije obeležen i postoje udarne rupe, verovali ili ne, prečnika 70 centimetara, dubine čak do 50 centimetara. Sve ovo, naravno, imamo dokumentovano i prosledićemo i Ministarstvu infrastrukture i prosledićemo gospodinu Kurtiju, koji snosi odgovornost za stanje ovakvog puta. Dakle, sa ovakvim oštećenjima ugrožena je bezbednost i putničkog i teretnog saobraćaja, a samim tim i svih onih koji se ovde voze i putuju.

Želim da znate da je ova deonica veoma frekventna i da se ovde voze deca, učenici, studenti, porodice i pozivam Ministarstvo infrastrukture i Vladu da nemaju diskriminatorski pristup prema ovom putnom pravcu i da nemaju predrasude zato što on prolazi kroz opštine sa srpskom većinom i nalazi se na severu. Dakle, ovaj putni pravac koriste i Srbi i Albanci i Bošnjaci i Goranci, svi oni koji žive ovde, tako da je ovaj putni pravac od bitnog interesa za sve nas.

Takođe, želim da znate da po nekim nezvaničnim podacima u roku od 24 sata na ovoj deonici puta zbog neobebeženog puta i zbog kompletne infrastrukture koja se nalazi u lošem stanju, dakle, imate na desetine oštećenja na putničkim i teretnim vozilima gde za ta oštećenja apsolutno niko ne snosi nikakvu odgovornost. Posebno je ovde rizično voziti se tokom noći i kada je smanjena vidljivost, gde zbog ovakvog stanja ovog puta možete da doživite neku saobraćajnu nezgodu.

Dakle, pozivamo Ministarstvo infrastrukture, pozivamo Vladu da što pre pokrene kompaniju koja je zadužena da održava ovaj putni pravac, da ih tamo ne šalju kao ovih dana što su to radili, da sa nekom neadekvatnom mehanizacijom, nekvalitetnim asfaltom i nestručnim zatvaranjem ovih udarnih rupa prave još veću štetu, zato što se ove udarne rupe posle tri dana opet otvaraju i opet se šire i opet ugrožavaju bezbednost svih učesnika u saobraćaju. Dajte taj kompaniju pokrenu tamo i da jednostavno urade sve kako struka nalaže. Dakle, da se uradi jedan stručni nadzor, da se uradi jedna stručna priprema i da se na jedan ozbiljan i temeljan način sanira ovaj putni pravac i tako bezbednost saobraćaja svih učesnika u saobraćaju bude na jednom boljem nivou nego što je to sada i da je problem rešen makar na neki malo duže period.

Takođe, želimo da skrenemo pažnju i Ministarstvu infrastrukture na deonici puta, odnosno regionalnog puta Grem-Belo Brdo koji se nalazi u opštini Leposavića, koji je takođe u katastrofalno lošem stanju. Dakle, želim da znate da ovaj putni pravac zapravo i ne postoji. U boljem je stanju neki makadamski put prema nekom selu nego ovaj koji je regionalni, koji prolazi kroz nekoliko sela i zaseoka u toj opštini i dolazi do rudnika Belo Brdo.

Dakle, rudnik gde se eksploatiše ruda i odatle se transportuje do Leposavića. Dakle, ovaj putni pravac je i od bitnog i od ekonomskog značaja za sve one koji žive u tom kraju. Tako da vas pozivam da preuzmete odgovornost, da ove putne pravace sanirate i da, naravno, ovi putni pravaci budu bezbedni za sve učesnike u saobraćaju. Hvala!

KRYETARJA: Faleminderit, vazhdojmë me AAK-në, zonja Time Kadrijaj. E tejkalova Grupin Multietnik, ju kërktoj ndjesë, Artan.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetare.

Të nderuar deputetë e qytetarë të Kosovës, muajin që lëmë pas muaji mars është muaji i epopeve të rëndësishme të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Epope-ja e UÇK-së, Epope-ja e Dukagjinit, por po ashtu janë përvjetorë të masakrave të kryera në Kosovë nga regjimi serb. Dje kryeministri Kurti ka qenë në masakrën në Lybeniq. Para disa dite ishim për t'i nderuar viktimat në Beleg të Deçanit, ku ende ka të pagjetur. A kemi të drejtë ne si shtet t'i fyejmë këto viktime? Nuk kemi të drejtë. Ne po bëjmë padrejtësi. E, po më vjen keq se në çfarë derexhe ka ra kjo qeveri, për një rezolutë, e cila nuk është politike për me i mbrojtur vlerat e luftës kemi kësi kundërshtime se ku të vendoset në rendin e ditës një rezolutë e tillë. A të jetë në fillim, a të jetë në fund.

Unë po e lus Andin Hotin, si ministër, Andin, bëjeni një ligj për mbrojtjen e vlerave të luftës, të takon si djali i Ukshin Hotit, njeri që ende nuk është gjetur dhe nuk dihet për varrin e tyre, ashtu siç dihet edhe për shumë viktime e tjera. Historia, të nderuar, ju të qeverisë, por dhe qytetarë të Kosovës nuk ndryshohet. Nuk mundeni ta ndryshoni me këto linçime që po i bëni edhe me këto

organizimet që po e bëni. Tërhiqni edhe librin për masakrat në Kosovë të Shkëlzen Gashit, i cili ka shkruar të pavërteta që është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, e që ai libër është shpërndarë nëpër vende të tjera.

Domethënë, vetë shteti i Kosovës ka shpërndarë libra me të pavërteta për të prezantuar një të pavërtetë në vendet e ndryshme të Evropës. Marre dhe sot është dashur të votohet kjo rezolutë, po edhe ta sillni sa më shpejt Ligjin për mbrojtjen e luftës.

KRYETARJA: Tani radha është nga Vetëvendosje.

Grupi Multietnik a e dëshiron dikush fjalën se radha është te ju? Grupi Multietnik, ju lutem! Zoti Artan Asllani fjala për ju.

ARTAN ASLLANI: Jo si grup nuk e marrim fjalën, por ka deputetë të interesuar.

KRYETARJA: Me radhë, prandaj pyeta. Nga Vetëvendosja kush është paraqitur, ju lutem, që të paraqiteni për fjalë. Zoti Enver Dugolli!

KRYETARJA: E nderuar kryetare e Kuvendit,

I nderuar kryeministër i Qeverisë së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qetarë!

Sot është 2 prilli, ditë e enjte, një ditë që për mua nuk është një datë në kalendar. Është një kujtesë, një plagë që u shndërrua në dritë. Është një premtim që nuk u shua kurrë, para 45 vjetësh, po në këtë ditë, ditë e enjte edhe atëherë rreth orës 10:30 u ngjita në një makinë mes një deti të rinjsh dhe me zërin që më dridhej jo nga frika, por nga pesha e përgjegjësisë: shpalla qëllimin dhe fillimin e demonstratave në Drenicë.

Aty nuk u fol vetëm, aty u lind një ide, një ide që nuk ishte thjesht politike, ishte ekzistenciale. Ne kërkuam liri, kërkuam barazi, kërkuam Kosovën Republikë. Nuk ishte një akt i zakonshëm, ishte momenti kur frika u përkul para guximit, kur heshtja u thye nga zëri i rinisë, kur një brez vendosi që të mos jetonte i përkulur.

Sot, pas 45 vjetësh përsëri është ditë e enjte dhe përsëri pothuajse me dallim një orë më vonë, por kësaj radhe nuk jam mbi një makinë në rrugë, jam në foltoren e Kuvendit të Republikës të Kosovës. Atëherë ne e ëndërronim republikën, sot jetojmë brenda saj dhe mes këtyre momenteve nuk ka vetëm kohë. Ka sakrificë, ka dhimbje, ka burgje, ka humbje, ka gjak, por mbi të gjitha, ka një dashuri që nuk u përkul kurrë për liri.

Ky është rrugëtim i një populli, nga rruga në institucione, nga protesta e lufta në shtet. Një ëndërr, një përgjegjësi, sepse republika nuk është vetëm ajo që kemi fituar, është edhe ajo që duhet ta meritojmë çdo ditë.

Demonstratat e vitit 1981 nuk ishin vetëm një shpërthim revolte. Ato ishin një zgjim i ndërgjegjes kombëtare, një moment kur një brez i tërë refuzoi të jetojë në padrejtësi. Dhe në atë rrugë rinia shqiptare nuk ishte vetëm pjesëmarrëse, ishte shtylla e historisë, në rrugë, në burgje, në familje, në heshtje, por gjithmonë duke mbajtur gjallë rezistencën dhe shpresën.

Të nderuar deputetë, sot sfida jonë nuk është më të kërkojmë republikën. Sfida jonë është ta ndërtojmë atë, ta bëjmë funksionale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Po, ju lutem regjia edhe një minutë zotit Dugolli.

ENVER DUGOLLI: Ta bëjmë të drejtë, ta bëjmë të denjë për ata që sakrifkuan gjithçka që ne të jemi sot këtu. Sot republika nuk është vetëm një emër në Kushtetutë, është një përgjegjësi morale, është një kontratë me historinë për një premtim ndaj çdo qytetari. Le të mos harrojmë kurrë, kjo foltore ku flasim sot është ndërtuar mbi zërin e atyre që dikur u dënuan pse folën.

Prandaj, nderimi më i madh për pranverën '81 nuk është vetëm përkujtimi, është përkushtimi ynë i përditshëm që kjo republikë të jetë më e drejtë dhe më e fortë për të gjithë, sepse ëndrra e një brezi nuk kërkon vetëm lavdi, kërkon vazhdim. Lavdi të gjithë atyre që guxuan në pranverën 1981. Rroftë Kosova Republikë!

Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu zoti Dugolli. Nga LDK-ja, zoti Zemaj apo Mustafa? Zoti Mustafa se jeni dy të paraqitur, prandaj më mirë t'ju pyes.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetare.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Kohëve të fundit jemi dëshmitarë të rritjes enorme të çmimeve të derivateve dhe një paralajmërim nga ana e ZRRE-së që me gjasë do të kemi dhe një rritje të çmimit të energjisë që nga 1 maji, pra një muaj nga tash.

Natyrisht këto rritje të çmimeve pastaj kanë një efekt zinxhiror tek të gjitha të tjerat.

Pra, kur të rritet çmimi i derivateve dhe i rrymës, do të ketë rritje të çmimeve të transportit, të ushqimit, të barnave, të ngrohjes, inputeve bujqësore që pastaj kanë dhe një efekt tjetër zinxhiror në vetvete, veshmbathje. Pra, kemi një efekt zinxhiror të rritjes së çmimeve të çdo produkti e të çdo shërbimi. Çdo familje në Kosovë çdo ditë përballet me vendimin se çka të blejnë e çka të mos blejnë.

Pra, çdo familje kosovare duhet të numërojë centët, sepse fatkeqësisht nuk arrin që të blejë çdo gjë që i nevojitet në çdo kohë. Çdo pensionist detyrohet që çdo ditë të numërojë centët sepse nuk mund të arrijë që të blejë çdo ditë të gjitha barnat dhe çdo ushqim që i nevojitet. E njëjta për çdo student, duhet të numërojë çdo ditë centë. E njëjta për secilin qytetar të Republikës së Kosovës çdo ditë detyrohet të numërojë centët, sepse çdo ditë ke rritje të çmimeve të naftës, të energjisë dhe çdo produkti si rrjedhojë i kësaj.

Jemi të vetëdijshëm, Kosova dhe nuk po e fajësojmë qeverinë për këtë, Kosova nuk kontrollon dhe nuk ka ndikim të çmimet e tregjeve ndërkombëtare të derivateve. Por, Kosova ka një qeveri dhe kjo qeveri është përgjegjëse ndaj qytetarëve të Kosovës që fillimisht t'i mbrojnë ata nga efektet e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe e dyta, që t'i përkrahë këta qytetarë që t'i përballojnë këto rritje të çmimeve qoftë të naftës e qoftë të energjisë elektrike dhe qoftë çdo produkti shërbimi që pastaj si rezultat çdo ditë rritet në çmim.

Kërkojmë që Qeveria e Kosovës urgjent të marrë masa edhe për të mbrojtur edhe për të përkrahur qytetarët në këtë situatë të rritjes të çmimeve të përditshme. Disa opsione, pra qoftë largim i përkohshëm ose zvogëlim i përkohshëm i akcizës në derivate, largim ose ulje komplet e TVSH-së për një periudhë derisa të kalojë kjo krizë energjetike globale, përkrahje financiare për qytetarët e Kosovës, veçanërisht për familjet e cenuara në aspektin socio-ekonomik. Si LDK vazhdimisht edhe në të kaluarën, edhe tash kemi qenë të gatshëm që të kontribuojmë në këtë drejtim.

Disa nga këto sugjerime vetëm i dhashë dhe jemi të hapur që të japim dhe sugjerime të ardhshme, por kërkojmë që Qeveria e Kosovës me urgjencë të trajtojë këtë çështje, sepse pas disa javëve, pas disa muajve do të jetë shumë vonë për të përkrahur qytetarët dhe për t'i mbrojtur ata. Faleminderit.

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Bylbyl Sokoli e ka fjalën, pastaj deputeti Veton Berisha. Po, Rregullorja nuk parasheh fjalë për deputetët që s'kanë grup parlamentar, por megjithatë po t'i jap tre minuta vetëm pas Bylbylit.

BYLBYL SOKOLI: E nderuar kryetare e Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës.

Për herë të parë po dal në këtë foltore dhe është një nder i veçantë për mua që sot të flas për një arritje të rëndësishme të sportistëve tanë.

Gjatë kualifikimeve për Kampionatin Botëror në futboll që do të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Meksikë, futbollistët tanë përfaqësuan me dinjitet dhe krenari shtetin tonë. Ata treguan përkushtim, sakrificë dhe shpirt garues, duke bërë që emri i Kosovës të dëgjohet dhe të respektohet në arenën ndërkombëtare. Kjo paraqitje nuk ishte vetëm një garë sportive, por dhe një mesazh i fortë se Kosova ka talent, ka vullnet dhe ka potencial për të arritur edhe më shumë. Sot më shumë se kurrë më parë sportistët e rinj kanë rrugët e garave kombëtare dhe ndërkombëtare të hapura, gjë që përbën një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin dhe afirmimin e tyre. Në këtë rast dua të falënderoj futbollistët, stafin dhe të gjithë ata që kontribuan në këtë rrugëtim. Ju faleminderit që na bëtë krenarë dhe që përfaqësuat vendin tonë me nder.

Megjithatë, për të arritur rezultate dhe më të mëdha në të ardhmen, sportistët tanë kanë nevojë për mbështetje edhe më të madhe. Kosovës i duhet një infrastrukturë sportive moderne, kushte më të mira për zhvillim dhe një bazë ligjore e qartë dhe funksionale që e mbështet sportin. Po ashtu, janë të domosdoshme projektet dhe programet e reja në mënyrë që talentet tanë të kenë hapësirën dhe mbështetje që meritojnë.

Në këtë drejtim është e rëndësishme të theksohet se institucionet dhe qeveria kanë filluar të punojnë për përmirësimin e kushteve në sport përmes investimeve dhe nismave konkrete, të cilat duhet të vazhdojnë dhe të intensifikohen edhe më tej. Ne mund të mos jemi kualifikuar, por dhe një edhe në këtë humbje kemi fituar diçka shumë të rëndësishme, respektin ndërkombëtar. Le të shfrytëzojmë këtë moment si motiv për të vazhduar përpara me më shumë investim dhe me një vizion të qartë për të ardhmen e sportit në Kosovë! Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Ardian Gola.)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Veton Berisha.

VETON BERISHA: I nderuar kryesues, faleminderit për mundësinë e fjalës!

I nderuar kryeministër Kurti,

Kabinet qeveritar,

Të dashur deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës!

Po e shfrytëzoj këtë të drejtë këtu në këtë pikë të rendit ditës, ku më jepet mundësia të ngre dy çështje të cila më takojnë t'i ngre, për shkak se përkojnë edhe lidhen drejtpërdrejt me komunitetin tim egjiptian. Më vjen mirë dhe besoj që janë disa prej ministrave kompetentë për

çështjet për të cilat unë do të flas, edhe do të mbajnë shënim, edhe bashkërisht besoj që për këto dy çështje do të marrin veprime konkrete.

Çështja e parë ka të bëjë me prezencën e fëmijëve në rrugë, për mua dukuria më e rëndë edhe më e shëmtuar, e cila ndodh para syve tanë, edhe çdo ditë ballafaqohemi me ta dhe nuk ka asnjë veprim institucional apo veprime për ta parandaluar këtë dukuri, e cila, vërtet, me keqardhje vjen për shkak të gjendjes së tyre ekonomike. Por, ne kemi shtet, kemi institucione, kemi një ligj i cili është i jashtëzakonshëm, por sipas asaj që ne e kemi parë, nuk ka mekanizma të duhur ku ne mund t'i mund t'i fusim nën kontroll dhe të kemi kujdes për ta.

Fëmijët janë kategoria më e ndjeshme. Ata përjashtohen edhe prej përgjegjësisë penale. Ata janë jo të vetëdijshëm për veprimet e tyre, por sigurisht duke pasur shtet dhe duke pasur institucione, secili prej neve ka të drejtë dhe ka mundësi. Jam i bindur që ka mundësi, vetëm të ketë vullnet, që kjo dukuri të futet nën kontroll dhe ne normalisht bashkërisht të mundohemi t'ua ndryshojmë gjendjen atyre familjeve dhe mos t'i keqpërdorë askush ata fëmijë në rrugë.

Besoj kjo është çështje që secili prej neve ballafaqohet çdo ditë, e një pjesë e madhe e tyre janë po ashtu edhe nga komuniteti rom dhe ashkali, por i bindur jam që janë edhe nga komuniteti egjiptian. Një dukuri që bashkërisht do të duhej të ndërmerrem veprime konkrete, me urgjencë, dhe të largohen nga rruga. Ata e kanë vendin në shkollë, nuk e kanë vendin në rrugë!

Dhe, çështja e dytë, është çështje që ndoshta ne komunitetet e përjetojnë më së shumti, është çështja e rritjes në masë të madhe të shprehjeve raciste kundrejt neve në institucione, në televizione, në rrugë. Kudo që ne sillemi, dëgjojmë që përdoren terma ku ne nuk na bëjnë të ndihemi mirë.

Normalisht, ka bazë ligjore, është vepër penale pjesërisht nxitja e urrejtjes ndëretnike, por konsideroj që nuk është mjaftueshëm dhe me zonzjën ministre të Drejtësisë do të kujdesemi që Kodi i Procedurës Penale ndoshta të ndryshohet, edhe ndoshta shprehjet, përdorimi i shprehjes sidomos në institucione dhe në mekanizma ku ne mund t'i thërrasim në përgjegjësi të kategorizohet si vepër penale. Asnjë sanksion deri tash. Ne personalisht jemi ballafaquar çdoherë.

KRYESUESI: Regjia shkurt, një kohë sa për ta përfunduar fjalën deputeti!

VETON BERISHA: Po e përmbyll.

Kemi institucione, kemi mekanizma dhe nuk ka nevojë asnjë prej neve prej deputetëve ose individualisht t'i marrë në dorë rastet e caktuar ku detyrohen persona të tillë ndoshta vetëm të kalojnë me një kërkim-falje dhe nuk ndërmerret asnjë veprim institucional. Normalisht, si çështje, nuk kam pasur mundësi ta ngre më herët për një periudhë shumë të gjatë kohore, por të

jeni të bindur që këto dy çështje që ne ballafaqohemi çdo ditë janë shumë të rëndësishme dhe ne kërkojmë ndërhyrjen e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Minutazhi i rregullt e kësaj pike të rendit të ditës tashmë është konsumuar pikërisht për shkak të mirëkuptimit që vazhdueshëm patëm për deputetët në zgjatjen e kohës në deklaratimet e tyre.

Gjithsesi, meqë i kemi edhe dy deputetë në rend, Armend Zemajn dhe deputeten nga AAK-ja, Albana Bytyqin, u japim fjalën edhe këtyre dyve, fillimisht Armendit dhe pastaj Albanës, dhe e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës. Ju faleminderit shumë!

Fjala për Armend Zemajn.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Për korrektësi e konsideratë, po mundohem të jem shumë i shkurtër, po të sjell në vëmendjen e Qeverisë edhe prezencën e kryeministrit, do të ishte e domosdoshme të ishte dhe ministri i Ambientit ose Infrastrukturës rreth rrugës së dëmtuar të Bjeshkëve të Rugovës. Ka disa vjet që ajo rrugë tashmë është bërë e pakalueshme ose më mirë të them vështirë e kalueshme, me problematika të mëdha për banorët që jetojnë në atë pjesë, por mbi të gjitha edhe për vizitorët, turistët, që është interes i asaj zone në zhvillimin ekonomik, por edhe në mirëqenien e qytetarëve që jetojnë atje.

Kërkoj urgjentisht që Qeveria të ndërhyjë në këtë pjesë; në rregullimin e asaj pjese dhe mbrojtjen po ashtu të bukurive natyrore që i ka falë vetë Zoti. Tash për ata banorë ka qenë edhe një vendim i kohës së fundit, i cili edhe më tutje e ka vështirësuar edhe komunikim, por edhe pjesën ekonomike që lidhet, mbi të gjitha dhe me jetesën, sepse ata jetojnë në prona private, ndërsa pronat e tyre janë nën kompetencë të mbrojtjes së ligjit që është për zonën e mbrojtur. Kjo duhet të jetë në konsideratë të Qeverisë dhe të Ministrisë, po të bëhet konform kërkesave ose mirëkuptimit të qytetarëve të asaj pjese dhe të asaj zone në tërësi, pa anashkaluar edhe Bjeshkët e Deçanit dhe bjeshkët e tjera, të cilët tashmë vetëm janë ngritur edhe në nivel të protestës. Kjo rrugë duhet urgjentisht të trajtohet. Ka pasur shumë debate kur dhe si të fillojë.

Po, është diku viti i pestë ose i gjashtë që flitet për rregullimin e saj dhe akoma nuk kemi ndonjë intervenim. Ndërsa, nuk besoj ose mund të jenë të rrallë edhe deputetët këtu që nuk kanë qenë viteve të fundit dhe e kanë parë edhe sa e vështirë është e kalueshme, si rrezikohet jeta e qytetarëve, mbi të gjitha e turistëve që nuk e njohin atë pjesë dhe mund të ketë edhe fatalitet për jetën e tyre.

Andaj, kërkoj nga ministria, sigurisht edhe nga Qeveria që sa më shpejt të marrë masa dhe të ndërhyjë në këtë pjesë, e cila do të sjellë edhe përfitime ekonomike, por edhe të mirëqenies së qytetarëve të asaj ane dhe bjeshkëve në tërësi të Rugovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, z. Zemaj! Fjalën e ka Albana Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës!

Këto ditë nuk u shpërnda vetëm paga e trembëdhjetë, por u shpërnda padrejtësia! Andaj, sot nuk po flasim vetëm për një pagesë shtesë, por për një vendim që po krijon një ndarje të qartë mes qytetarëve të këtij vendi.

Para se të hyja sot këtu në sallë, takova një punëtor të sektorit privat, i cili më tha: “Punojmë çdo ditë, paguajmë tatime, po kur vjen puna te pagesa, duket se për Qeverinë nuk po ekzistojmë”. Kjo fjali fatkeqësisht nuk është vetëm historia e tij personale. Ajo përfaqëson përvojën e përditshme të qindra-mijëra qytetarëve që e mbajnë ekonominë në këmbë. Po flasim për punëtorë të ndërtimtarisë, shitës, profesionistë të rinj në teknologji, punëtorë shërbimesh dhe prodhimi; pra për shumicën dërmuese të fuqisë punëtore në vend.

Në këtë kontekst, vendimi i Qeverisë merr një kuptim edhe më të rëndë. Sot është bërë një ndarje e qartë. Një grup që shpërblehet dhe një tjetër që punon, paguan dhe lihet jashtë. Po flasim për mbi 250 mijë punëtorë të sektorit privat që po përjashtohen, ndërkohë që ky sektor pikërisht kontribuon në pjesën më të madhe në ekonominë e vendit dhe në mbushjen e buxhetit të shtetit.

Prandaj, me të drejtë lind pyetja: çfarë mesazhi po u jepet këtyre njerëzve; që puna e tyre vlen më pak, që kontributi i tyre nuk ka peshë, që tatimet e tyre nuk janë të mirëseardhura, por vetë ata jo. Kjo nuk është thjesht një politikë e gabuar. Në thelb, kjo është një qasje e gabuar në vetë rolin e Qeverisë, sepse një qeveri që mbështet vetëm një pjesë të shoqërisë dhe injoron tjetrën, nuk po ndërton barazi, po thellon ndarjen sociale dhe po cenon besimin e qytetarëve në institucione.

Prandaj, kjo nuk mund të quhet ndryshe; kjo është diskriminim i vetëdijshëm ndaj sektorit privat! Andaj, si opozitë, ne e kundërshtojmë fuqishëm këtë padrejtësi dhe kërkojmë masa konkrete, jo justifikime. Kërkojmë që politika të përfshijë çdo punëtor, çdo kontribut dhe çdo qytetar që e mban në këmbë këtë vend.

Dhe në fund, kam një mesazh për qytetarët: Mos pranoni të trajtoheni si qytetarë të dorës së dytë në vendin tuaj! Mos e pranoni këtë si normale, sepse padrejtësia që tolerohet sot kthehet në standard nesër dhe drejtësia nuk mund të matet me atë që jepet, por me ata që lihen jashtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputetja Bytyqi! Atëherë e konsiderojmë si të konsumuar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Por, para se të kalojmë te pyetjet parlamentare, Qeveria e ka radhën, nëse ka anëtarë të Qeverisë që duan të komentojnë, qoftë çështjet e ngrehura nga deputetët, qoftë çështje që kanë të bëjnë me to.

Po! Kryeministri Kurti e kërkon fjalën.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: I nderuar nënkryetar Gola,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar ministra të Qeverisë,

Të dashur qytetarë të Republikës!

Mirë se e gjejmë njëri-tjetrin në seancë plenare të Kuvendit të Republikës sërish, në rikthimin e shtëpisë së demokracisë, pothuajse një muaj pas dekretit të Presidentes për shpërndarjen e tij. Dekreti i lëshuar ishte në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka krijuar një situatë, e cila kërkon qartësi, jo konfuzion; e cila kërkon përgjegjësi, jo shmangie.

Gjykata Kushtetuese ka folur për natyrën e republikës sonë demokratike e parlamentare dhe për kufijtë që Kushtetuta i vendos çdo institucioni. Në këtë rend, shpërndarja e Kuvendit nuk është instrument për të tejkaluar vështirësi politike dhe, mbi të gjitha, është vërtetuar e dëshmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese tash, që presidenti nuk mund të shpërndajë vullnetin e popullit, as nën presion të afateve e të paqartësive kushtetuese. Vullneti i popullit nuk anulohet me dekrete e, rrjedhimisht, as nuk shpërndahet.

Tani, pas qartësimit dhe vërtetimit të kësaj të vërtete të pamohueshme, sot nuk kemi një boshllëk institucional përpara nesh, por kemi një detyrë të qartë. Kuvendi është funksional dhe i kthehet punës së tij. Mandati i deputetëve është i gjallë dhe përgjegjësia ndaj proceseve e politikave publike është edhe më e madhe. Afatet kushtetuese janë në rrjedhë. Shteti nuk ka ndalur së vepruari dhe nuk ka asnjë arsye që ne ta ndalim atë.

Përkundrazi, çdo përpjekje për ta ndërprerë këtë funksionim do të ishte jo vetëm politikisht e gabuar, por edhe një precedent që cenon vetë idenë e ndarjes dhe balancës së pushteteve. Demokracia nuk mbahet në këmbë e nuk avancohet përpara duke e bllokuar punën dhe funksionin e njëra-tjetrës, por duke e respektuar çdo pushtet tjetër brenda kufijve të përcaktuar nga vetë Kushtetuta.

Kjo nuk është një çështje abstrakte apo debat teorik. Vazhdimi i punës së institucioneve tona është më konkret se kurrë. Por njëkohësisht edhe më i nevojshëm se asnjëherë më parë. Pra, rruga para nesh nuk duhet të jenë pengesat, inatet apo refuzimet për të ecur përpara, por çka

pritet prej nesh është miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, agjenda legislative që e përmirësojnë përditshmërinë e qytetarëve pa dallim, politika publike në dobi të brezave që vijnë e që kërkojnë konsistencë dhe siguri juridike.

Dhe të gjitha këto nuk mund të mbahen peng të një krize të prodhuar politikisht. Vullneti i popullit është shprehur më 28 dhjetor, në zgjedhje të lira e demokratike, tash ne duhet të flasim për vullnetin tonë për t'i shtyrë përpara punët e mira për qytetarët. Andaj, duhet të kthehemi aty ku kemi mbetur dhe të vazhdojmë punën tonë me seriozitet.

Qytetarët presin që ne të procedojmë sa më shpejt me Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, sepse lufta kundër korrupsionit nuk është një kapitull që hapet dhe mbyllet sipas nevojës politike, por është një vijë e pandërprerë që e ndan drejtësinë nga padrejtësia. Diçka që qytetarët pa dallim partie e kërkojnë dhe e mirëpresin. Nëse qytetarët e mirëpresin, nuk ka arsye që partitë të mos e mbështesin.

Ne nuk kemi ardhur këtu për të menaxhuar një realitet të deformuar, por jemi përgjegjës për ta ndryshuar pozitivisht atë. Dhe ndryshimi fillon aty ku shteti e bën të qartë se çdo cent i keqpërdorur nga zyrtarët publikë duhet t'i kthehet atij që i takon, pra qytetarit. Nëse qytetari i zakonshëm duhet të japë llogari për çdo cent që e fiton, atëherë edhe ai që është pasuruar në mënyrë të pajustificueshme duhet të japë përgjigje për çdo euro që ka abuzuar.

Këtë nuk e bëjmë si një akt hakmarrjeje, por si një akt barazie. Sepse një shtet që nuk i dënon të fortit e padrejtë, në fakt i braktis të dobëtit çdo ditë. Nëse i kërkojmë tatimin secilit që punon me djersë në ballë e me mund fizik a intelektual dhe vjen i rraskapitur çdo mbrëmje, atëherë cila është arsyeja që të mos kërkojmë nga ata që pa asnjë përpjekje i çel mëngjesi të pasuruar?!

Derisa presim mbështetje për ligjin për Byronë, pra abuzimet me fondet publike, ne gjithashtu presim mbështetjen për mbrojtjen e qytetarëve nga abuzimet me çmimet e larta. Pozita dhe opozita janë dëshmitarë që qytetarët tanë kanë ankesa për abuzime me çmime të larta. Atëherë, nëse pajtohemi për problemin, duhet të pajtohemi edhe me zgjidhjen.

Me fjalë të tjera, duhet ta rikthejmë ligjin për çmimet tavan, jo si një debat ideologjik, por si një përgjigje konkrete ndaj një realiteti që çdo familje e ndien përditë. Bota po kalon nga kriza në krizë: një luftë që ka nisur nuk përfundon, fillon një tjetër që as nuk mendonim se do të nisë.

Nga pandemia e vitit 2020, te lufta në Ukrainë në vitin 2022, e së fundmi edhe lufta në Lindjen e Mesme, ndërkohë që krizës energjetike të vitit 2022 po i shtohet edhe ajo e vitit 2026. Ju e dini që secilës sfidë i jemi përgjigjur me pako konkrete ekonomike dhe jemi munduar që në çdo dimension, në mandatin e kaluar, të ndihmojmë secilën kategori shoqërore.

Por, sikur në secilën krizë, ju e dini, të nderuar deputetë, që dikush zgjedh të përfitojë. Ka tregtarë, biznese të mëdha që e kanë keqpërdorur krizën për të rritur artificialisht çmimet. Andaj, kur çmimi i produkteve bazike rritet përtej çdo logjike ekonomike, kur tregu e humb sensin e drejtësisë dhe qytetari mbetet i pambrojtur, atëherë shteti nuk mund të fshihet prapa parimeve abstrakte. Ai duhet të ndërhyjë me maturi, por edhe me vendosmëri. Sepse liria ekonomike nuk mund të kthehet në liri për të shfrytëzuar dhe tregu nuk mund të jetë një hapësirë ku më i forti vendos gjithmonë mbi më të dobëtin.

Duhet theksuar që të njëjtën iniciativë e morëm edhe më herët për këtë, por u pati kontestuar në Gjykatë Kushtetuese nga opozita. Pra, ankesa për çmime të larta u bë ankesë në Gjykatë Kushtetuese kundër ligjit për të ndaluar abuzimin me çmime!

Tash shumë shpejt do ta risjellim këtu për ta votuar dhe presim që edhe opozita të reflektojë dhe të na mbështesë në këtë projektligj. Sepse ky projektligj i ri, por në thelb i vjetër, mbron nga abuzimi me çmime të larta të gjithë qytetarët. Pra, ata që na mbështesin ne si mazhorancë, por edhe qytetarët që mbështesin PDK, LDK, AAK e kështu me radhë.

Prandaj, problemet e përbashkëta kërkojnë zgjidhje të përbashkët dhe presim përkrahje të të gjithëve. Duke theksuar gjithmonë se kjo nuk është ndërhyrje kundër tregut; kjo është ndërhyrje për drejtësi në treg. Dhe drejtësia në treg është pjesë e drejtësisë në shoqëri.

Të nderuar deputetë,

Nëse shteti duhet të jetë i drejtë në ekonomi, ai duhet të jetë po aq i drejtë në hapësirën publike. Hapësira publike është e të gjithëve, që do të thotë e asnjërit me emër të përveçëm. Dhe këtu hyn një tjetër çështje që nuk mund të anashkalohet: media.

Një demokraci nuk jeton vetëm nga vota qytetare, por edhe nga fjala e thënë. Dhe kjo duhet të jetë e lirë për të qenë e vlefshme. Por fjala nuk mund të jetë e lirë nëse është e kapur nga interesa të fshehta. Raportimet për financime me thasë parash nuk janë vetëm një problem i etikës profesionale; ato janë një kërcënim i drejtpërdrejtë për integritetin e debatit publik. Sepse kur paraja hyn në mënyrë të padukshme, ajo nuk blen vetëm hapësirë mediatike, ajo blen ndikim, orienton narrativën dhe, në fund, deformon perceptimin e qytetarit.

Një qytetar i dezinformuar nuk është qytetar i lirë. Ai është i manipuluar dhe, siç tregojnë edhe raportet, ky manipulim po vjen direkt nga armiqtë tanë, por që fatkeqësisht po gjejnë edhe argatin e tyre brenda vendit tonë.

Ne nuk kemi asnjë interes të kufizojmë mediat. Përkundrazi, kemi interes që ato të jenë më të forta, më të pavarura, më hulumtuese dhe më kritike. Por, pavarësia nuk mund të ndërtohet mbi fshehtësi që financojnë shpifjen dhe dezinformimin.

Liria editoriale duhet të jetë e garantuar, por ajo duhet të shoqërohet me transparencë të plotë të pronësisë dhe të financimit. Qytetarët duhet të dinë se kush flet, në emër të kujt flet dhe me çfarë burimesh flet, si dhe nga kush financohet.

Nëse secili biznes tjetër jep përgjegjësi për financat dhe burimet e tij, mediat gjithashtu duhet të jenë në të njëjtin nivel të përgjegjësisë. Kjo edhe e mbron qytetarin nga manipulimi dhe dezinformimi, por edhe i mbron gazetarët dhe mediat e ndershme që raportojnë e informojnë me burime të sakta dhe financa të gjurmueshme.

Ligji për Këshillin e Pavarur për Media që do ta sjellim para jush nuk është për të kontrolluar median, por për ta mbrojtur atë nga kapja. Censurë është pengesa e lajmit të drejtë, jo e lajmeve të pavërteta me financime të dyshimta.

Një demokraci që nuk e sheh këtë rrezik në kohë rrezikon të humbasë lirinë pa e kuptuar; dhe, me të njëjtën logjikë, ka vepruar edhe Bashkimi Evropian kur ka mbyllur transmetimin e portaleve dhe televizioneve ruse.

Nëse në diktatura të dikurshme kontrolloheshin rezultatet, sot nga oligarkia ka rrezik të kontrollohen premiset në mënyrë që të manipulohen rezultatet. Sot, grupet e interesit nuk e prekin lirinë e shprehjes; ato kontrollojnë ekonominë e medias, ashtu që mos të ketë nevojë për ndërhyrje në lirinë e shprehjes.

Të nderuar deputetë,

Në fund, të gjitha këto çështje, nga dekreti të marrëveshjet ndërkombëtare, nga lufta kundër korrupsionit të drejtësia në treg dhe transparenca në media, lidhen me një parim të vetëm që duhet të na udhëheqë, por edhe të na bashkojë: sundimi i ligjit.

Një shtet i së drejtës kërkon përgjegjësi dhe llogari. Ne do të vazhdojmë punën tonë që Republika jonë e përbashkët të jetë shembull për qytetarët pa dallim dhe model për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Populli ynë ka vuajtur shumë nga padrejtësitë e të huajve dhe prandaj kërkon llogari e drejtësi nga përfaqësuesit e vet. Kuvendi është shtëpia ku shtyhen politika që kërkojnë përgjegjësi nga ata që kanë abuzuar me fonde publike, ku vihen standarde për fjalën publike, ku mbështeten marrëveshje ndërkombëtare dhe kërkohet përgjegjësi për ata që abuzojnë me lirinë e shprehjes, si dhe përkrahen iniciativa që i mbrojnë qytetarët nga abuzime me çmime të larta.

Kjo është detyrë e të gjithë neve dhe prandaj duhet edhe mbështetje e të gjithëve bashkë.

Këto iniciativa do të jenë të gjitha shumë shpejt para jush, prandaj edhe presim që t'i adresoni, diskutoni, procedoni dhe miratoni sa më shpejt.

Prandaj sot nuk e kemi luksin e vonesës. Nuk e kemi luksin e bllokadës. Dhe nuk kemi nevojë për zgjedhje të reja të sërishme, si ikje nga përgjegjësia që na takon.

Kosovën, institucionet e saj legjitime, me vullnet të shprehur rishtazi e qartësisht nga qytetarët, duhet ta lëmë të punojë. Ka pasur mjaftueshëm zgjedhje e rizgjedhje. Qytetarët kanë folur mjaftueshëm.

Tani na duhet të punojmë sa më shumë, sa më shumë që të mundemi bashkë, e jo të kemi bllokada të reja që nuk e lënë vitin e vjetër të jetë në të kaluarën.

Bllokadat, grackat, kleçkat, taktikat, nuk janë mendësi e zhvillimit, por e ngecjes. Është koha që të ecim përpara dhe të jemi në krye të detyrës, veçanërisht në këto rrethana jo të lehta globale. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.)

KRYETARJA: Kryeministër, faleminderit! Fjalën e ka zoti Tahiri për çështjet që ishin diskutim, edhe të kryeministrit. Ju lutem, zoti Tahiri, dy minuta! Apo, zoti Haradinaj? Zoti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryetare,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Të dashur qytetarë,
Edhe sot erdhi mashtruesi para nesh me një mashtrim ideal. Po ju tregoj që na mashtroi...

KRYETARJA: Të lutem, kujdes fjalorin, zoti Haradinaj!

RAMUSH HARADINAJ: Ju lutem, mashtrimi nuk është fyerje. Sot ndodhi një mashtrim në këtë fjalim.

KRYETARJA: Ju lutem që të kujdeseni për fjalorin në Kuvend!

RAMUSH HARADINAJ: Ndodhi një mashtrim në këtë foltore, e po dua ta demaskoj këtë mashtrim të mënyrës më të keqe të mundshme. E para, kolegu që foli para meje këtu është sa vjet në pushtet. Mban përgjegjësi për çmimet, mban përgjegjësi për vjedhjen që po na ndodh në energji, për faturat që po na vijnë.

Ky edhe Qeveria e tij edhe ju mbani përgjegjësi dhe s'mund t'i ikni kësaj përgjegjësie në asnjë variant. As s'mund të fshiheni pas këtij Ligji për çmimet tavan, as kurrgjë, se oligarkët e tu, kryeministër, janë duke shitur e duke blerë energji dhe po ju shtohen kompanitë përditë e më shumë njerëzve të afërm tuaj. Duhet të ketë një korrektësi këtu në këtë rast.

E dyta, thotë, po financohen mediat me thasë. Dëgjojeni se çfarë po thotë ky. Dëgjojeni mirë çka po thotë; po financohen mediat me thasë. Ky shpenzon më së shumti pare duke ushqyer zagarë për të fyer shqiptarët...

KRYETARJA: Ju lutem, regjia, ia ndalni fjalën! Kur deputeti ose anëtari i Qeverisë përdor gjuhë joparlamentare, me sjelljen e tij pengon zhvillimin e seancës plenare, ose e cenon rregullin e seancës, kryesuesi i seancës plenare jep vërejtje duke deklaruar se është duke përdorur gjuhë joparlamentare. Zoti Haradinaj, ju lutem uluni në vendin tuaj! Ju kërkoj që të uleni në vendin tuaj. Po përdorni gjuhë joparlamentare. Ju lutem që të uleni në vendin tuaj, zoti Haradinaj!

Vazhdojmë me rendin e ditës: Pyetjet parlamentare

Koha për pyetje parlamentare zgjat deri... Po, zoti Zemaj për çështjet që lidhen, ju lutem! Dy minuta, deputeti Zemaj.

ARMEDN ZEMAJ: Faleminderit!

Kryeministër, sa herë është shtrenjtuar energjia elektrike në qeverisjen tuaj brenda këtyre viteve? A ke folur ndonjëherë për Martin Berishajn për arrestimin e Nagip Krasniqit? A ke dalë t'u tregosh deputetëve të Kuvendit të Kosovës pse ai është i arrestuar? Ku janë milionat e Martin Berishajt? Ku kanë shkuar? Kë e ka financuar, nëse po flasim për financim?

Sulmoji mediat në mënyrë tjetër. Kërko transparencë, llogari, ligj, për të gjitha ato është e drejtë. Po jo vetëm kur ty të pëlqen ose kur juve ju pëlqen, e të tjerat nuk u pëlqejnë. Reporterët pa Kufij, ambasadat, organizatat kredibile ndërkombëtare të kanë vendosur në listën e zezë për ndërhyrje në pavarësinë e mediave.

Për çfarë po flasim sot? Për çfarë lirie, e të drejta të njeriut? Për çfarë shteti funksional, ku funksionon rendi dhe ligji. Andaj, këto tema dhe këto përgjigje duhet dhënë. Ose, e fundit, pse e ke financuar Shkëlzen Gashin të botojë libër me të pavërtetat e luftës? Ministria e kujt është? Kush është i pari i Qeverisë? Kush është titullari? Jep llogari për ato para, që i ke shpërndanë nëpër krejt botën demokratike, ato të pavërteta. E atëherë dil e arsyetojini këto veprime të tjera.

KRYETARJA: Deputeti Besian Mustafa, edhe vazhdojmë te pyetjet parlamentare. Ju lutem deputet, dy minuta!

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetare!

Kryeministër, ju dëgjova me vëmendje. Desha vetëm të ngre dy tema. Folët për luftën ndaj korrupsionit. Më lejo të të rikujtoj, se me gjasë nganjëherë po i harroni detajet e rëndësishme kur e keni sjellë këtu në Kuvend Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, partia juaj, deputetët tuaj nuk kanë arritur t'i kenë votat e mjaftueshme për ta kaluar atë ligj dhe kanë qenë 5 deputetë të LDK-së që jua kanë dhënë ato vota për ta kaluar atë ligj. Pra, me LDK-në e keni kaluar, me përkrahjen e LDK-së e keni kaluar Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë. Pra, e keni pasur përkrahjen dhe e keni përkrahjen tonë për ta luftuar korrupsionin deri në fund, por duhet të jeni të sigurtë me analizën tuaj.

Dhe, sa i përket Ligjit për çmimet tavan. Po, kryeministër, e kemi dërguar në Gjykatë Kushtetuese, por do të duhej që ju të skuqeni pse e keni bërë një ligj jokushtetues, e jo ne. Përsëri e përsëris, e keni përkrahjen tonë për një ligj, i cili është brenda Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Do ta keni përkrahjen e LDK-së.

Keni një ligj në Qeverinë tuaj, keni vendosur një Ligj për vendosjen e çmimeve tavan te derivatet. Atë ligj nuk e kemi dërguar në Gjykatë Kushtetuese, e keni aktiv. Po përkundër asaj, çmimet e derivateve janë jashtë kontrolli, por rriten nga dita në ditë. Pra, nuk është kjo zgjidhje ajo që po e kërkon, por e sillni një ligj kushtetues këtu, do ta keni përkrahjen edhe të LDK-së. Faleminderit!

KRYETARJA: Unë mirëpres Projektligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë që e ka bërë së fundi Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe përnjëmend uroj që të jemi të unifikuar që ta trajtojmë pasurinë e pajustificueshme, se besoj që është jashtëzakonisht ligj shumë i rëndësishëm.

Në ndërkohë edhe zonja Albena Reshitaj e ka fjalën dy minuta dhe vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetare!

Veç desha, sa për informacion, Projektligji për Byronë për konfiskim të pasurisë së paluajtshme ka kaluar me votën time në atë kohë.

Kështu që, është mirë të jemi më të sigurtë kur flasim. Me votën time ka kaluar, e fatkeqësisht deri sot ka mbetur ku ka mbetur, e ne duhet tani sërish ta sjellim në Kuvend për ta kaluar, dhe ju them që do ta votoj sërish dhe besoj që secili deputet i Republikës së Kosovës duhet ta votojë këtë projektligj kaq të rëndësishëm, sepse qytetarët tanë po presin. Faleminderit!

KRYETARJA: Sa mirë të shohim kështu luftë të madhe që të kalojë ky ligj. Uroj që të vazhdojmë njësoj kur të procedohet në seancë. E qartë është, e qartë është. Besoj që është e

qartë, zoti Mustafa, se ke të drejtë, veç ndaj Qeverisë, jo ndaj deputetëve. Herën tjetër. Ministria Rizvanolli e ka fjalën. Ju lutem, ministre!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Të nderuar deputetë,

Disa prej jush e ngrehët çështjen e çmimit të energjisë elektrike dhe e ndërlidhët këtë me disa akuza që janë të paqena me informata që tashmë janë demantuar disa herë si të pabaza nga të gjitha institucionet.

Edhe një herë dua t'i përsëris disa fakte rreth rritjeve të çmimit të energjisë elektrike që ka ndodhur gjatë viteve të kaluara. Këto rritje kanë ndodhur në një kontekst të një krize botërore energjetike, e cila ka kulmuar në vitin 2021 dhe 2022. Mirëpo, edhe në vitin 2025, çmimet e importit të energjisë elektrike kanë vazhduar të jenë mesatarisht trefish e më se trefish më të larta sesa që kanë qenë para krizës së vitit 2021 dhe 2022. Pra, një krizë e cila ka vazhduar të ketë pasojë, e cila tani për më tepër po keqësohet për shkak të luftës në Iran.

E dyta, shumë e rëndësishme që të përmendet në këtë kontekst është që rritja e çmimit të energjisë elektrike vitin e kaluar ka ndodhur edhe për shkak të investimeve që po bëhen në KEK, e që nuk janë bërë për 40 vjet, investime të cilat kanë qenë të planifikuara për të cilat studimi i fizibilitetit në KEK është bërë që në vitin 2017, mirëpo realizimi nuk ka filluar deri vitin e kaluar.

Vitin e kaluar blloku B2 ka qenë jashtë operimit për katër muaj e gjysmë për arsye se është bërë modernizimi i turbinës dhe janë bërë investime të tjera përcjellëse, të cilat e rritin kapacitetin, e kanë rritur kapacitetin prodhues të kësaj njësie dhe të cilat e kanë bërë operimin më të sigurt dhe e kanë rritur sigurinë e furnizimit. Kjo është një arsye që ka kontribuar që vitin e kaluar prodhimi të jetë më i ulët.

Gjithashtu, para tre vjetësh, për herë të parë është bërë një investim i madh - dilatimi i bojlerëve, i cili ka qenë një parakusht për zbatimin e projektit të faltarëve për të cilin kemi biseduar. Për këtë arsye, dy blloqe të termocentralit Kosova B, secili nga tre muaj kanë qenë jashtë funksionit dhe kjo gjithashtu ka kontribuar në uljen e prodhimit të energjisë elektrike, i cili shpesh në media nga aktorë të ndryshëm, edhe opozitarë, është interpretuar si keqmenaxhim, e ulje prodhimit e të tjera, gjë që është e pabazë.

Sivjet kemi pasur një kërkesë për rritje, mirëpo ZRRE-ja ende nuk ka dalë me raportin.

Prandaj, siç kemi thënë, pasi të dalë ZRRE-ja me raportin konsultativ, ne do ta vlerësojmë dhe do t'i dërgojmë komentet tona. Këto janë fakte që duhen njohur dhe duhen pranuar nëse duam të flasim në mënyrë konstruktive dhe reale për sektorin e energjisë.

Investimet që nuk janë bërë për 40 vjet në termocentralin Kosova B, prej kur ekziston, e që nuk janë bërë në termocentralin Kosova A për 60 e më shumë vjet që ekziston termocentrali Kosova A, po bëhen gjashtë vjetëve të fundit dhe do të vazhdojnë të bëhen edhe sot, javën tjetër më saktësisht fillon ë modernizimi i njësisë B1 të termocentralit Kosova B, i cili gjithashtu do ta rrisë prodhimin, do ta rrisë eficiencën e prodhimit dhe do ta ulë ndotjen nga termali për çdo megavat orë të prodhuar. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Edhe ministrja Kusari-Lila e ka fjalën për çështjen e njësorëve. Vetëm pak, ju lutem! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, e nderuara kryetare e Kuvendit!

Nënkryetare,

Kryeministër,

Zëvendëskryeministre,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Kënaqësi të jemi bashkë në seancë të punës. Uroj të jetë e tillë dhe të vazhdojë të jetë e tillë në kontribut dhe në të mirë të shtimit të vlerës të qytetarëve të Republikës. Nga përvoja ime, nga ana tjetër, sa isha bashkë me ju deputetë të nderuar, e kemi parë shumë herë e me vite të tëra se ngritja e zërit nuk e forcon argumentin, në të kundërtën, e dobëson atë. Prandaj, këtu jemi për t'i prezantuar argumentet dhe faktet.

Dy çështje për të cilat desha t'ju drejtohem nga ato çka u ngritën nga ju, të nderuar deputetë, në raport edhe me çmimet e derivateve të naftës, por edhe me çështjen e njehsorëve.

Ligji për metrologjinë, domethënë për Agjencinë e Metrologjisë në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit parasheh edhe vlerësimet, përkatësisht verifikimin e jashtëzakonshëm të njërive matëse. Më konkretisht, më lejoni t'ju informoj, në bazë të nenit 26 të këtij projektligji, në të cilin bëhet kërkesa për verifikim të jashtëzakonshëm, është themeluar grupi punues ad hoc nga ministria që drejtoj, nga dy përfaqësues të Agjencisë për Metrologji dhe në mbikëqyrje të Inspektoratit Qendror të Tregut, dhe të cilët sipas kërkesave të konsumatorëve, të cilat deri në momentin kur çështja është aktualizuar publikisht nuk ka qenë as edhe një kërkesë te Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Ditën e djeshme, ashtu siç e kemi bërë publike dhe do ta bëjmë publike çdo ditë të javës, kanë qenë 70 kërkesa për verifikim të njehsorëve. Sot janë bërë 206 kërkesa. Verifikimi vetëm ka filluar tek Agjencia për Metrologji dhe deri më tani nga verifikimi, i cili në fund të ditës do të bëhet publik se cilat janë problemet apo cilat janë, domethënë teknikisht të identifikuar çështjet në kuadër të njehsorëve nuk kanë të bëjnë me ndryshim deri më tani të vëllimit, apo të sasisë së energjisë së matur janë të tarifave apo të kohëve tarifore.

Prandaj, edhe sipas legjislacionit në fuqi, edhe në kuadër të Ministrisë të Industrisë Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, por gjithashtu edhe të Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, këto informacione bashkë edhe me specifikat e analizës do të dërgohen te Zyra e Rregullatorit për t'u marrë masat. Ndërsa, ky ligj i njëjti, neni 46 i Ligjit për metrologjinë parasheh edhe sanksionet dhe dënimet për subjektet fizike dhe gjithashtu për organizatat.

Më lejoni t'jua rikonfirmoj se ministria dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nuk qëndron këtu për ta mbrojtur, ose për ta mbuluar askënd, qëndron...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe një minutë, ministres!

MINISTRJA MNIMOZA KUSARI-LILA: ... për t'u dhënë gjithë qytetarëve dhe konsumatorëve mbrojtjen që u takon. Prandaj, edhe sipas kërkesave të tyre, ne në secilën shtëpi apo amvisëri dhe ku ka pasur njehsorë, ku kanë kërkuar verifikimin, verifikimi është bërë dhe është në proces për t'u bërë.

Sa i përket çmimit të derivateve, ligji që përcakton marzhën e fitimit është i qartë. Marzha e fitimit përcaktohet në bazë të çmimit të importit. Jemi shoqëri importuese në sektorin e derivateve dhe marzha në vlerë prej dy centë për shumicë dhe 12 centë për pakicë ka qenë ajo, e cila është verifikuar gjatë këtij muaji. Më 4 prill skadon afati i vendimit të parë dhe jemi në përgatitje të vendimit të dytë me informacionet e zbatimit të vendimit të deritashëm, por gjithashtu edhe informacione të tjera dhe plotësimet që do të vijnë edhe nga dikasterët përkatës për mbrojtjen e qytetarëve.

KRYETARJA: Vetëm ju lutem, sepse duket që këtu ka një paqartësi.

Gjithnjë duke iu referuar Rregullores së Kuvendit, pas deklarimit të anëtarit të Qeverisë mund të deklarohet edhe deputeti që e ka parashtruar çështjen. Pra, ndërlidhet me çështjet paraprake. Në këtë pikë nuk mund të vazhdojmë tutje. Zoti Zemaj po, por ti ia dhe të drejtën zotit Haradinaj. Të drejtën tënde e barte te zoti Haradinaj. Zoti Zemaj, ju lutem, dy minuta dhe zoti Tahiri dy minuta dhe vazhdojmë. Nuk ka të tjerë për fjalë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetare!

Me të vërtetë është për të ardhur keq kur del një ministre, ose duhet me pasur një zor të madh të dalë dhe të thotë deputeti, ose u referohet e pavërtetave.

Zonja ministre, ty të është arrestuar në vitin 2023 Nagip Krasniqi, dhe ende është me aktakuzë aktive në proces gjyqësor nga Prokuroria Speciale për keqpërdorim të tenderëve, pikërisht të atyre tenderëve që po flasim edhe ne. Çfarë ka të pavërtetë këtu? A mund ta mohosh që Martin

Berishaj ka tërhequr miliona dhe nuk është nën hetim? Cila është e pavërteta? Pse e mbron një person, i cili është me aktakuzë, dhe thua është e pavërtetë. Është në proces aktiv gjyqësor. Çka të lidhë ty me të? A ke përgjegjësi? Edhe del thua këtu, “u thanë disa të pavërteta”. Një kompani e vetme t’i ka marrë 300 milionë euro për eksport të energjisë elektrike, afro 300 milionë t’i ka marrë. Gati 1 miliardë ke importuar energji elektrike për tre vjetët e fundit.

Hajde, cila është e pavërteta? Në vend se të kërkosh ndihmë dhe në vend se t’u kërkosh falje qytetarëve të Kosovës, që nuk e je duke mundur ta menaxhosh këtë sektor, edhe krejt po i marrim parasysh krizat globale, ti del e thua këtu “u thanë disa të pavërteta”. Të pavërtetat i thua ti, ose mundohesh t’i mbulosh mashtrimet, keqpërdorimet, hajnitë dhe të pavërtetat e juaja. Kaq!

KRYETARJA: Nuk ka të drejtë zoti Haradinaj, më vjen keq. E ke pasur të drejtën, nuk e shfrytëzove, por fyeve. Kështu që tash nuk të vjen radha, më vjen shumë keq. Po, ministrja Rizvanolli.

Ministre, fjala është për ju!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Çështjet individuale që janë duke u trajtuar nga Gjyqësori, unë nuk mund t’i komentoj. Mirëpo, me këtë rast dua të qartësoj një gjë që thuhet shpesh, e që nuk është e vërtetë, e kjo është që Nagip Krasniqi akuzohet se ka vjedhur para. Dëmi i cili pretendohet nga Prokuroria në rastin e kontratës së njësisë A5, pretendohet për fitime të humbura, të cilat nuk janë dëshmuar, ndërsa jo për vjedhje.

Duke qenë se është një çështje që flitet shumë publikisht, aktakuza dhe të gjitha informatat janë publike, mendoj që është mirë të jemi të qartë kur flasim se për çka jemi duke folur. Ndërsa, gjykimin sigurisht e bën dikush tjetër.

U thanë dhe janë thënë shpesh shumë të pavërteta në lidhje me pretendimet për lidhjet e Qeverisë ose Lëvizjes Vetëvendosje ose secilit zyrtar me kompanitë që tregtojnë energji. Nuk ka asnjë lidhje ndërmjet kompanive që kanë tregtuar energji gjatë viteve të fundit dhe zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, apo të Qeverisë. Këto janë komplet të pabaza, mirëpo, meqë e përmendët kompaninë, e cila ka tregtuar energji gjatë viteve të fundit, unë e kam një pyetje për ju: Çka ndodhi që e ndalët këtë temë para disa muajsh? A ka ndodhur një tender i ri dhe e ka fituar këtë kontratë dikush tjetër tash dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! S’ke replikë as kundër-replikë, u krye Armend. Faleminderit! Zotit Tahiri dhe e mbyllim këtë pikë të diskutimeve të rendit të ditës. Zoti Tahiri, dy minuta nëse vazhdon me gjuhë joparlamentare, të lutem të kesh konsideratë, sepse nuk mund të vazhdojmë.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kryeministri i Kosovës u mundua të na e bartë përgjegjësinë neve si deputetë të opozitës për disa çështje që janë saktësisht të qarta. E para, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, kryeministrit të Kosovës, i kërkon ta gjejë një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit. Kanë kaluar tetë ditë, nuk ka asnjë veprim që do të na çojë deri në momentin e fundit me bllokadën e njëjtë dhe t'i thërrasë edhe njëherë 1 milion qytetarë që të dalin për të votuar.

Është përgjegjësia e 66 deputetëve, e kësaj partie, për të gjetur zgjidhje, e jo ta bartë fajin dhe jo ta sjellë një kandidat të partisë së vet. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është bukur i qartë, nuk kemi nevojë për interpretim, por kemi nevojë për veprim për t'i parandaluar zgjedhjet.

Çështja e dytë, te Byroja e Konfiskimit, shumë është duke u folur. Ju them këtu publikisht, kurdo që të vijë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë Byronë për Konfiskimin e Pasurisë. I them publikisht kryeministrit, le të jem unë i pari si zyrtar publik dhe ky i dyti që të na hetohet pasuria, e të shikojmë qysh u arrit ajo pasuri.

Sa ka ky e sa kam unë, për shembull, dhe të mos manipulohet në këtë temë për shkak se është temë puro politike, në mënyrën që të adresohet gishti. Pra, të parëve neve të dyve të na e hetojnë pasurinë.

Çështja e tretë, te çmimet tavan - çmimet i ka çuar në tavan kjo qeveri, këto politika. Ligji për çmimet tavan është sjellë për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Dy minuta i pate Besnik, edhe unë nuk ta ndal fjalën, regjia e ndërpret në momentin kur e konsumon kohën tënde. Një minutë dhe mbylle, të lutem!

BESNIK TAHIRI: Po, çështja tjetër, çmimet janë duke u ngritur në vazhdimësi. Një shembull konkret, a e kemi dërguar letrën për ta ulur akcizën dhe për ta ulur TVSH-në? A ka ndonjë veprim prej Qeverisë, përveç që thotë nuk bëhet, me një amandamentim mund të vijë ligji këtu për t'u amandamentuar për një periudhë kohore dhe në këtë krizë të zvogëlohet çmimi. Nuk ka vullnet politik, ka vullnet politik vetëm për ta goditur fjalën e lirë, mediat, opozitën, pa asnjë argumentim. Ka qëllim shumë të thjeshtë, të kapet edhe njëherë edhe pozicionin e presidentes, dhe atëherë të instalohet autokracia, e cila nuk do të ndodhë.

KRYETARJA: Faleminderit, edhe koha në dispozicion ka përfunduar. Vazhdojmë me pyetjet parlamentarit, që zgjasin 60 minuta.

3. Pyetjet parlamentare

Sipas nenit 92, paragrafi 8 i Rregullores së Kuvendit, në rast se anëtari i Qeverisë nuk mund të jetë i pranishëm në seancën në kohën e pyetjeve parlamentare, e njofton paraprakisht kryetarin për mungesën e tij.

Në këtë rast, unë kam njoftim nga ministri Dimal Basha, që e ka pasur të pamundshme që të jetë i pranishëm në këtë seancë. Prandaj, me njoftimin e tij, unë po e njoftoj edhe deputeten Fjolla Ujkani. Megjithatë, vazhdojmë te pyetjet parlamentare. Janë pesë pyetje parlamentare që janë proceduar për këtë seancë. Është deputetja Fjolla Ujkani.

FJOLLA UJKANI: Faleminderit, kryetare!

Meqenëse ministri nuk është prezent, pyetjen po e bart për në seancën e radhës, por meqenëse e kam fjalën do të doja që ta adresoja një shqetësim, nëse veç më lejoni.

KRYETARJA: Nuk ke të drejtë, deputete!

FJOLLA UJKANI: Në rregull!

KRYETARJA: Ministri s'është këtu, e parashtron pyetjen në seancën e ardhshme. Vazhdojmë me deputeten Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Dimal Basha. Deputetja nuk është e pranishme, as ministri Basha, por ministri Basha më ka njoftuar për mungesën e tij.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Dimal Basha, sërish. Pra, deputetja nuk është këtu, as ministri Dimal Basha.

Deputeti Eman Rrahmani, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Deputetin Eman Rrahmani nuk e kemi këtu, kryeministrin e Republikës së Kosovës e kemi këtu.

Megjithatë, duhet të vazhdojmë te pyetja e fundit. Deputeti Eman Rrahmani ka parashtruar pyetje për kryeministrin Albin Kurti, sërish deputetin nuk e kemi këtu, kryeministri është këtu.

Po vazhdojmë tani me pika të tjera të rendit të ditës, sepse nuk ka pyetje të tjera parlamentare. Para se të futemi te çështjet e marrëveshjeve ndërkombëtare, unë i ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë që kanë këto marrëveshje ndërkombëtare, që të vijmë në këtë seancë plenare.

Prandaj po presim vetëm pak minuta. Regjia, ju lutem të ndihmoni në thirrjen e deputetëve përmes mekanizmave që i kemi me rënien e ziles.

(Ndërprerje e shkurtër)

I lus deputetët që të mos lëvizin nga salla, sepse për pak fillojmë me marrëveshjet. Ju lutem, deputetë, të zini vendet tuaja. Po, vazhdojmë me:

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes për qasje në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor

Me këtë rast, Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë dhe Teknologji e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Në radhë të parë, ftoj ministrin e Arsimit, zoti Hajrullah Çeku, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër!

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, zonja kryetare!

Deputetë, deputete të nderuara,

Para jush paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për qasjen në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor.

Kjo marrëveshje, e nënshkruar më 14 tetor 2024, në Berlin, nga përfaqësues të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë synon të krijojë një hapësirë më gjithëpërfshirëse dhe më funksionale të arsimit të lartë në rajon.

Përmes kësaj lehtësohet qasja dhe pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë, duke hequr pengesat administrative dhe duke afruar standardet akademike ndërmjet shteteve pjesëmarrëse. Qëllimi i marrëveshjes është të sigurojë qasje më të lehtë dhe të pranimit të diplomuarve nga arsimit mesëm dhe të studentëve të shteteve palë të marrëveshjes që dëshirojnë të fillojnë studimet e tyre në institucionet publike të arsimit të lartë.

Marrëveshja vlen në të gjitha nivelet e arsimit të lartë dhe përfshin institucionet publike të akredituara në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke krijuar mundësi më të mëdha për mobilitet akademik dhe bashkëpunim ndëruniversitar.

Disa nga përfitimet që sjell kjo marrëveshje janë rritja e cilësisë në arsimin e lartë, thjeshtimi i procedurave administrative dhe krijimi i mundësive të barabarta për studentët tanë për të studiuar në universitetet në rajon. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të mbështetet nga një komision i përbashkët, i cili do të sigurojë koordinimin dhe monitorimin e proceseve përkatëse. Një nga instrumentet kyçe të këtij komisioni të përbashkët është edhe lista e përbashkët e institucioneve

publike të arsimit të mesëm, që do të specifikohet për qëllimet, qasjen dhe pranimin në arsimin e lartë.

Me këtë marrëveshje mundësohet që maturantët dhe studentët të kenë lehtësi për të filluar studimet në universitetet publike të shteteve të tjera të rajonit mbi bazën e kushteve dhe kritereve të njëjta.

Po ashtu, marrëveshja siguron trajtim të barabartë për arsimim sa i përket pagesës, akomodimit dhe bursave sipas legjislacionit të shtetit pritës, si dhe vendos standarde të njëjta pranimi për të gjithë aplikantët.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka kjo marrëveshje, ju ftoj të gjithëve që ta ratifikoni projektligjin përkatës! Faleminderit!

KRYETARJA: Ministër, faleminderit për fjalën! Tani është radha e Komisionit përkatës për Arsim. Kryetarja e komisionit, znj. Arjeta Fejza.

ARJETA FEJZA: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në bazë të nenit 29, 30 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur 3. 3. 2026, e shqyrtoi Projektligjin nr. 10/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes për qasjen në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor.

Komisioni vlerësoi se me Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes synohet të garantohet mobiliteti akademik i studentëve dhe njohja e kualifikimeve të arsimit të mesëm dhe të lartë në rajon.

Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, i rekomandon Kuvendit miratimin e tij. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, kryetare e komisionit! Tani radha e grupeve parlamentare. Nga vetëvendosja, znj. Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Për arsye të cilat tashmë i prezantoi edhe ministri Çeku, pra duke qenë se kjo marrëveshje lehtëson qasjen dhe pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë, në institucionet

publike të arsimit të lartë në rajon, nxit mobilitetin akademik dhe po ashtu njohjen e kualifikimeve të arsimit të mesëm të lartë dhe atyre të nivelit bachelor, ne e inkurajojmë dhe e mbështetim këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit znj. Nagavci! Nga LDK-ja, znj. Lushaku, shefja e grupit.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Ashtu siç kemi paraqitur këtë miratimin tonë dhe përkrahjen tonë për marrëveshjet ndërkombëtare, edhe në këtë rast shprehim dhe e mbështetim edhe marrëveshjen në fjalë.

KRYETARJA: Faleminderit! Lista Serbe, nuk e dëshiron fjalën. Grupi Multietnik? Zoti Asllani!

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Duke parë rëndësinë e shqyrtimit të këtyre marrëveshjeve, ne jemi pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

KRYETARJA: Faleminderit, z. Asllani! Nga AAK-ja, z. Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Aleanca për Armërinë e Kosovës do ta votojë marrëveshjen ndërkombëtare.

KRYETARJA: Faleminderit, z. Tahiri! Nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë.

Fillimisht, më duhet t'ju kërkoj që të votojmë për prezencë.

Prandaj, ju lutem regjia që të jeni gati. Votojmë tash, për prezencë!

Lus deputetët që të votojnë për prezencë, ata që janë të pranishëm në këtë seancë. Pra, është me rëndësi, sepse jemi para votimit të marrëveshjes.

Votojmë edhe një herë për prezencë!

Po presim dy minuta, sepse po më njoftojnë që janë duke ardhur deputetët. Ju lutem, mos lëvizni ju që jeni këtu!

Atëherë po vazhdojmë!

Votojmë edhe njëherë për prezencë! Ju lutem, votoni për prezencë! Votojmë tash!

Vazhdojmë me votimin e marrëveshjes: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes për qasjen në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor.

Përgatitemi për votim! Votojmë tash!

Konstatohet se me 81 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon Projektligji nr. 10/ L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes për qasje në arsimin e lartë për praninë për studime në Ballkanin Perëndimor.

Faleminderit deputetëve për mbështetjen!

Vazhdojmë me marrëveshjen tjetër:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-009 për ratifikimin e Amendamentit “nr.3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018”

Tani, sipas radhës, kërkohet deklarimi i Qeverisë. Kryeministër!
Urdhëroni, kryeministër!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë,

Sot paraqesim për miratim Projektligjin për ratifikimin e amendamentit nr. 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2018.

Qëllimi i amendamentimit të kësaj marrëveshjeje është që zgjatja e afatit kohor për zbatimin e projekteve, përkatësisht që afati përfundimtar për zbatim të jetë 10 vjet pas arritjes së marrëveshjes fillestare, dhe meqenëse ajo marrëveshje ka hyrë në fuqi në vitin 2019, afati për zbatim zgjatet deri në vitin 2029.

Kërkesa për këtë shtyrje ka ardhur nga Zyra e Bashkimit Evropian, e cila është autoritet kontraktues për projektet IPA në Kosovë, meqenëse afati i mëhershëm për marrëveshje fillestare, i caktuar për gjashtë vjet, më tej i zgjatur në shtatë vjet me amendamentin 2, nuk ishte i mjaftueshëm për zbatimin e projekteve për shkak të vonësave që ka pasur gjatë zbatimit të projektit të ndërrimit të filtrave në Termocentralin Kosova B.

Marrëveshja u nënshkrua dhe Projektligji për ratifikimin e saj është miratuar në Qeveri në dhjetor të vitit 2024, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit nuk është përfunduar procesi, prandaj edhe projektligji është miratuar sërish nga Qeveria aktuale më 20 shkurt dhe tani duhet të ratifikohet në Kuvend.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe kërkojmë mbështetjen tuaj!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Tani ftoj nënkryetaren e Komisionit FunkSIONAL, znj. Liza Gashi, për shkak se kryetarja Hykmete Bajrami nuk është këtu.

LIZA GASHI: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mbledhjen e Komisionit për Integritime Evropiane, të mbajtur më 26. 2. 2026, në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL, komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 10/L-009 për ratifikimin e amendamentit nr. 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2018.

Qëllimi i amendamentit nr. 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018 është shtyrja e afatit të zbatimit të marrëveshjes për të mundësuar realizimin e plotë dhe të suksesshëm të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, të cilat janë përballur vonesa gjatë zbatimit dhe miratimit të tij.

Prandaj, Komisioni për Integritime Evropiane i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit nr. 10/L-009 për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, nënkryetare!

Tani është radha e grupeve parlamentare. Nëse s'e dëshiron askush fjalën, sepse nuk kam të paraqitur, nga AAK-ja po e shoh znj. Kadrjaj. Po, znj. Kadrjaj.

TIME KADRJAJ: Ne jemi deklaruar se do t'i votojmë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, por e kam një kërkesë, të mos shkohet me këto procedurat e stërzgjatura, me ekspozitë të zgjatura, qoftë nga Qeveria, apo edhe nga anëtarët e komisionit që i prezantojnë ato, të shkohet pak më shpejt në procesin e votimit, do të ishte më mirë.

KRYETARJA: Qeveria po të mbështet, e nderuar deputete!

Qeveria po të mbështet në këtë kërkesë. Po besoj që edhe grupi parlamentar, njësoj. Faleminderit për kontributin!

Tani, ju lutem që të përgatitemi për votim! Ju lutem që t'i zini vendet tuaja. Deputetë!

Regjia, vazhdojmë me votimin e Projektligjit nr. 10/L-009 për ratifikimin e amendamentit nr. 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018.

Përgatitemi për votim! Votojmë për projektligjin tash!

81 deputetë kanë votuar për Projektligjin numër 10/L-009 për ratifikimin e amendamentit nr. 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018.

Asnjë kundër nuk kishte, asnjë abstenim, pra 81 vota për.

Po e votojmë pra tash edhe presidentin? I kemi kandidaturat gati, veç a votoni...

Vazhdojmë me marrëveshjen tjetër:

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-010 për ratifikimin e “Amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Programin IPA 2017”

Pra, sipas dakordimit që e patëm më herët, duhet të vazhdojmë me votimin e këtij projektligji. Presim një minutë!

Në këtë marrëveshje kemi një amendament, prandaj këtë duhet ta paraqesë nënkryetarja.

Nënkryetare, keni një amendament si komision. A jeni e gatshme tani ta procedoni amendamentin që e keni bërë si komision?

LIZA GASHI: Faleminderit, kryetare!

Atëherë në amendament ka një propozim shumë të thjeshtë teknik, që propozohet neni 1, në fund të tekstit në fjalën ‘part one’ zëvendësohet me fjalën: pjesa e parë.

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Përgatitemi për votim! Votojmë së pari amendamentin e propozuar nga komisioni funksional, të cilit iu referua nënkryetarja Liza Gashi.

Votojmë tash për amendamentin!

Konstatoj se kalon amendamenti me 81 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Votojmë tani Projektligjin për ratifikimin e amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2017, pjesa e parë.

Votojmë tash!

Me 81 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 10/L-010 për ratifikimin e amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2017, pjesa e parë.

Vazhdojmë me pikën tjetër:

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-011 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia Diellore Fotovoltaike në KEK - Porta Globale

Këtu nuk ka amendamente komisioni, edhe votojmë tash për këtë projektligj!

Me 80 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, konstatohet se Kuvendi miratoi Projektligjin nr. 10/L-011 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale. Faleminderit deputetëve!

Vazhdojmë me projektligjin e radhës:

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-012 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Projektin e efijencës së energjisë në ndërtesa publike

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 81 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 10/L-012 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e efijencës së energjisë në ndërtesa publike. Faleminderit!

Vazhdojmë tani me marrëveshjen e radhës:

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-013 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë “Projekti i Rrugës me Shpejtësi të Lartë Prishtinë - Mitrovicë” (Kredi shtesë) ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Republikës së Kosovës

Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 10/L-013 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë “Projekti i Rrugës me Shpejtësi të Lartë Prishtinë - Mitrovicë” (Kredi shtesë) ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Republikës së Kosovës. 80 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-014 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë”

Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Konstatohet se me 81 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 10/L-014 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë.

Faleminderit shumë të gjithë deputetëve për mbështetjen e këtyre marrëveshjeve!

Tani më lejoni që t’u referohem pikave të reja të rendit ditës që ndërlidhen me marrëveshjet ndërkombëtare, por paraprakisht duhet që të shmangemi nga Rregullorja, apo jo sekretar? Vetëm një minutë, ju lutem!

Të nderuar deputetë,

Shqyrtimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet jo më herët se një javë nga dita e shpërndarjes së tij. Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 27 mars 2026. Andaj, shqyrtimi i këtij projektligji duhet të bëhet me shmangie nga afati procedural i paraparë me nenin 83, paragrafi 4 i Rregullores së Punës së Kuvendit. Prandaj në këtë drejtim, votojmë njëherë për shmangie nga Rregullorja për shkak të arsyeve që i përmenda dhe pastaj votojmë për projektligjin.

Votojmë për shmangie. Regjia, ju lutem! Atëherë, kalon me 71 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim. Kalon shmangia. Realisht shmangemi nga afati procedural i paraparë me nenin 83, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit.

*** Projektligji nr. 10/L-015 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e zhvillimit të sektorit financiar të Kosovës**

Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Nuk ka kuorum për kalimin e këtij projektligji. Duhet të jenë 80 vota për.

Pra, nuk konsiderohet që marrëveshja nuk ka kaluar, por që nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës. Përveç kësaj, janë edhe tri marrëveshje të tjera, por për shkak të mungesës së kuorumit duhet të vazhdojmë me:

11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë nga radhët e komunitetit shqiptar dhe për dy (2) anëtarë joshumicë në Komisionin e Pavarur të Mediave

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, i ka propozuar Kuvendit që ta formojë një komision të vetëm ad hoc për pikën 11 dhe 12 të rendit të ditës. Për formimin e Komisionit ad hoc është kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radha e komunitetit shqiptar.

Prandaj, me këtë rast, e ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që të propozojë kryetarin dhe 4 anëtarë të komisionit.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Kryesues, propozojmë që të jetë deputeti Alban Bajrami, ndërkohë anëtarë të tjerë Arbëreshë Kryeziu, Egzon Azemi, Fitim Haziri dhe Nezir Kraki.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar deputeten Ganimete Musliu për zëvendëskryetare të parë dhe deputeten Ariana Musliu-Shoshi për anëtare të komisionit.

Tani radhën e ka Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Lushaku.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: E propozojmë deputetin Ermal Sadiku.

KRYETARJA: Faleminderit, kryetare!

Tani vazhdojmë me Grupin Parlamentar të Listës serbe, që në fakt e paskan propozuar deputetin Igor Simiq për zëvendëskryetar të dytë të komisionit. A e dëshironi fjalën, apo është e mjaftueshme kjo? Meqë është bërë propozimi me shkrim, atëherë po e konsiderojmë që është propozuar deputeti Igor Simiq për zëvendëskryetar të dytë të komisionit.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar Multietnik që të propozojë 1 anëtar të komisionit. Zoti Artan Asllani!

ARTAN ASLLANI: Fridon Lala.

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar! Ftoj Grupin Parlamentar të AAK-së që të propozojë 1 anëtar të komisionit.

BESNIK TAHIRI: Time Kadrijaj.

KRYETARJA: Faleminderit! Tani procedojmë me votim. Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votimin e komisionit. Votojmë tash!

Konstatoj se me 77 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radha e komunitetit shqiptar dhe për përzgjedhjen e kandidatëve për 3 anëtarë nga radhët e komunitetit shqiptar dhe për 2 anëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë në Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ngarkohet Komisioni ad hoc që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

13. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për gjashtë (6) anëtarë nga komuniteti shqiptar, një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Për formimin e Komisionit ad hoc, po flas shumë shpejt, ndoshta kjo është e vështirë për përkthyesit. E kuptoj. Ju kërkoj ndjesë përkthyesve! Po përpiqem të lexoj më ngadalë.

Për formimin e Komisionit ad hoc është kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 6 anëtarë nga komuniteti shqiptar, 1 anëtar nga komuniteti serb dhe 1 anëtar nga komunitetet joshumicë në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zonjën Arbërie Nagavci, që të propozojë kryetarin dhe 4 anëtarë të komisionit.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Këtë grup do ta kryesojë unë, Arbërie Nagavci. Anëtarët të tjerë nga grupi ynë parlamentar janë deputetët: Alban Bajrami, Arbëreshë Kryeziu, Fitim Haziri dhe Nezir Kraki.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci! Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar deputetet Ganimete Musliu dhe Ariana Musliu-Shoshi për anëtarë të komisionit. Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të LDK-së. Zonja Lushaku, fjala është për ju. Për zëvendëskryetarin e parë të komisionit.

JEHONA LUSHAKU: LDK-ja e propozon deputetin Armend Zemaj në këtë komision.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Lushaku! Tani Grupi Parlamentar i Listës serbe e ka propozuar deputetin Slavko Simiq për anëtar të komisionit. Ftoj Grupin Multietnik që ta propozojë zëvendëskryetarin e dytë të komisionit.

ARTAN ASLLANI: Ne e propozojmë zonjën Emilija Rexhepi për këtë komision.

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar! Ftoj Grupin Parlamentar të AAK-së që të propozojë 1 anëtar të komisionit. Zoti Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Time Kadrijaj do të jetë përfaqësuese.

KRYETARJA: Faleminderit! Tani procedojmë me votim. Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votimin e komisionit. Votojmë tash!

Me 76 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenimin, Kuvendi formoi komisionin...1 abstenimin. 76 vota për, asnjë kundër, 1 abstenimin, Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 6 anëtarë të komunitetit shqiptar, 1 anëtar nga komuniteti serb dhe 1 anëtar nga komunitetet joshumicë në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Ngarkohet Komisioni ad hoc që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime. Faleminderit!

Pika e radhës është:

14. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e deputetit Branislav Nikoliq në komisione parlamentare

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar Lista serbe ka propozuar që në komisionet parlamentare, ku anëtar ka qenë ish-deputeti Zlatan Elek, të zëvendësohet me deputetin Branislav Nikoliq.

Ish-deputeti Zlatan Elek ka qenë i zgjedhur anëtar në Komisionin Parlamentar për Integrim Evropian dhe në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Prandaj procedojmë me votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e emëroi deputetin Branislav Nikoliq për anëtar të Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian dhe në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Tani e kemi pikën e radhës:

15. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Zubin Potokut për vitin 2026

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar buxhetin e Komunës së Zubin Potokut për vitin 2026 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, si dhe ka rekomanduar që Ministria e Financave këtë buxhet ta paraqesë në tabelat buxhetore të Ligjit nr. 010/L-001 mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Prandaj, me këtë rast e ftoj ministrin e Financave, Hekuran Murati, për fjalë.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse kemi pasur një komunë, e cila është vonuar ta dorëzojë buxhetin në afat kohor, ne kemi vepruar sipas asaj që parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike.

Pra, konkretisht që në rast se komuna e dorëzon pas afatit dhe pasi të jetë miratuar Ligji për ndarjet buxhetore, Ministria e Financave përmes Qeverisë e procedon në Kuvend për miratim.

Ky buxhet në vlerë prej 3 559 002 euro ka kaluar, ka marrë mbështetjen edhe të komisionit parlamentar. Nuk është i ndryshuar meqenëse parashihet, pra është buxhet komunal, procedohet i tillë siç është miratuar edhe në kuvendin komunal. Faleminderit!

KRYETARJA: Të falënderoj ministër për fjalën! Tani e ftoj kryetarin e komisionit, zotin Enver Haliti, për arsyetimin e raportit të komisionit. Zoti Haliti!

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

Atëherë, komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, e ka shqyrtuar buxhetin e Komunës Zubin Potokut për vitin 2026 dhe ka vendosur që Kuvendi t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

Të miratohet buxheti i Komunës së Zubin Potokut për vitin 2026 dhe Ministria e Financave të pasqyrojë në tabelat buxhetore të Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar kryetar i komisionit! A e dëshiron dikush tjetër fjalën? Nëse jo, atëherë përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se 74 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim, për buxhetin e Komunës së Zubin Potokut për vitin 2026.

Pika e radhës:

16. Formimi i Komisionit ad hoc për hartimin e “Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes”

Të nderuar deputetë,
Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, pas shqyrtimit të nismës për hartimin e Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes, i ka propozuar Kuvendit që ta formojë një Komision ad hoc për hartimin e këtij projektligji.

Gjithashtu, është kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për hartimin e Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes.

Vetëm ta sqaroj që sipas nenit 45, paragrafi 4 i Rregullores, Kuvendi brenda dy javësh nga diskutimi në Kryesinë e Kuvendit vendos sipas propozimit të Kryesisë për detyrat, numrin, përbërjen dhe afatin kohor të veprimtarisë së Komisionit ad hoc.

Prandaj, ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që të propozojë zëvendëskryetarin e parë dhe 4 anëtarë të komisionit.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Atëherë, për këtë komision propozojmë deputetin Haxhi Abdyli, deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, deputeten Labinotë Demi dhe Edona Lalloshi. Ndërkohë që për zëvendëskryetare e propozoj deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar deputetin Artan Behrami për kryetar të komisionit dhe deputeten Sala Jashari për anëtare të komisionit.

Ftoj shafen e Grupit Parlamentar të LDK-së, zonjën Jehona Lushaku-Sadriu, që ta propozojë 1 anëtar të komisionit.

JEHONA LUSHAKU: Meqë ky projektligj ka të bëjë edhe me shkollat, dëshiroj ta propozoj veten.

KRYETARJA: Faleminderit! Besian, pate mundësi ta propozoje Jehonën. Faleminderit!

Atëherë, zonja Jehona Lushaku-Sadriu është anëtare e këtij komisioni. Vazhdojmë me Listën serbe. Lista serbe e ka propozuar deputeten Liljana Stefanoviq për zëvendëskryetare dytë të komisionit. Grupi Multietnik, Artan!

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Unë, para se ta propozoj, veç desha ta bëj një njoftim të shkurtër. Grupi Multietnik që nga sot përbëhet prej 9 deputetëve, i është bashkangjitur edhe Veton Berisha. E për këtë komision e propozojmë Erxhan Galushin.

KRYETARJA: Faleminderit! Prandaj edhe ia dhashë fjalën më herët. Nejse, nënkryetari Gola. Ju uroj punë të mbarë si grup parlamentar. Vazhdojmë tani me Grupin Parlamentar të AAK-së. Besnik, e ke fjalën.

BESNIK TAHIRI: Time Kadrijaj.

KRYETARJA: Faleminderit!

Procedojmë me votim. Lus deputetët që të bëhen gati për votim. Regjia, votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se me 78 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për hartimin e Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes.

Ngarkohet Komisioni ad hoc që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-025 për nisma legislative dhe Kuvendit t'ia paraqesë Projektligjin për parandalim të vetëvrasjes në afat prej gjashtë muajsh.

Me këtë po i mbyllim punimet e kësaj seance. Marrëveshjet që nuk arritëm t'i kalojmë për shkak të mungesës së kuorumit barten në seancën e ardhshme të këtij Kuvendi.

Mirupafshim në seancën e radhës! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*